

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI  
Zv/kryeredaktor: Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7350 E shtunë 11 Nëntor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

**Opinion** **Ditës**

**M**ediat kishin pakënaqësi edhe ndaj Presidentit Barak Obama në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Sipas disa raportimeve, administrata e tij investonte tepër...  
Vijon në faqen 21

Nga JULIAN ZYLA

**Çështja "Mediat"**



**Opinion** **Ditës**

**V**endimi i pak ditëve më parë prej Gjykatës Administrative në Tiranë lidhur me padinë e banorëve të Margegajt dhe shoqatës "Toka", që kërkonte anulimin...  
Vijon në faqen 12

Nga BEN ANDONI

Shqipëria, me paterica në BE edhe sa i përket transparencës mjedisore



Kushëriri, sekser i 46-vjeçarit  
**Iu gjetën 300 mln lekë, në shtëpi, prangoset gjyqtari Miri. Liroi të dënuarin për dy vrasje**

Priten arrestime të dy gjyqtarëve të tjerë.  
Kush është i akuzuari Gentian Doda  
Nga INA ALLKANJARI

**BLUETOOTH**



**Aldon Lipe, baba për herë të dytë. Krëfthet Erisa Xhixho: I thashë "stop" fushatës për djalin**  
Suplement

## MANUALI I RI ISSH, KUSHTET E PËRFITIMIT PËR BURRAT E GRATË, NË BAZË TË VJETËRSISË NË PUNË

# PENSIONET, LLOGARITE PER VITET DHE MOSHEN

Tabelat sipas kategorive për secilën gjini. Dokumentet që duhet të dorëzohen për të vërtetuar periudhat e sigurimit dhe llojin e punës për pension pleqërie



(Në foto) Instituti i Sigurimeve Shoqërore

- NEGOCIATAT**  
**Bushati-Kotzias, 12 orë diskutime në Kretë për defin e ligjin e luftës**  
Në faqen 5
- VENDIMI**  
**Shtyhet afati për përfundimin e procesit të marrjes së tapive mbi tokën**  
Në faqen 6
- INTERVISTA**  
**Flet Adi Krasta: Gjuha e Ramës me mediat, s'komentoj figurat në rënie**  
Në faqen 23
- NGA MIRA BREGU**  
**Çekia, 900 mijë USD për mbrojtjen e Ballkanit Perëndimor nga ndryshimet klimatike**  
Në faqen 21

Libri "Sekretet e luftës", Shqipëria tjetër në dokumentet britanike të Erald Kaprit  
**Raporti anglez më '44: Enver Hoxha, kukull e emëruar**  
"Miladin Popoviç pa takt e acarues, Haxhi Lleshi ogurzi, Mehmet Shehu brutal"

Nga ERALD KAPRI  
**L**ibri "Sekretet e Luftës" Shqipëria tjetër në dokumentet britanike i Erald Kaprit është rezultat i një pune 4-vjeçare të një shqyrtimi dhe leximi të dokumentacionit voluminoz në Arkivin Britanik, që u përket viteve



1943 dhe 1944, si dhe dokumente për fillimet e regjimit të Enver Hoxhës. Mbi 20 mijë faqe dokumente autentike janë lexuar dhe mes tyre janë përzgjedhur dokumente që hedhin dritë për disa nga çështjet më të nxehta të luftës, që nga bashkëpunimi...

Në faqen 18-19

## NDALIMI I GJYQTARIT HETIMI

46-vjeçari: Vetëm një pjesë e parave ishin të miat. Prokuroria: Të arrestohet!

# Iu gjetën 300 mln lekë në banesë, ndalohet gjyqtari Shkëlqim Miri

*Policia: Mori ryshfet, liroi të dënuarin për dy vrasje*

Ina Allkanjari

TIRANË

Shkëlqim Miri, gjyqtar i Gjykatës së Apelit në Tiranë u ndalua mbrëmjen e së enjtes nga policia e më urdhër të prokurorisë, pasi dyshohet të ketë favorizuar një të dënuar. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se 46-vjeçari u kap gjatë operacionit të koduar "Një vrasje e dytë", pasi dyshohet se ka marrë ryshfet dhe ka liruar nga burgu të dënuarin për dy vrasje, Gentian Dodën. Ndërkohë, me vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda është ushtruar kontroll në banesën e gjyqtarit Miri, ku u gjetën dhe u sekuestruan 174,810 euro; 10,149,000 lekë dhe 1,000 dollarë. Mësohet se gjyqtari në fjalë akuzohet për veprat penale: "Korrupsion aktiv të gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë" dhe "Korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë". Ndërkohë, prokuroria ka depozituar në Gjykatën e Krimeve të Rënda, kërkesën për arrest me burg ndaj Shkëlqim Miri. Pas ndalimit të gjyqtarit, në "rrjetë" ka rënë edhe kushëri i tij, Kujtim Miri, i cili dyshohet se përdorej si sekser nga 46-vjeçari. Sakaq priten të tjera arrestime në lidhje me këtë ngjarje. Burime të rezervuara pranë organit të akuzës nuk përjashtojnë as arrestimin e ndonjë gjyqtari tjetër. Sipas këtyre burimeve, janë vënë nën hetim dhe dy gjyqtarë e tjerë që liroan Dodën.

### HETIMI

Grupi hetimor i ka nisur hetimet për gjyqtarin e Apelit, Shkëlqim Mirin në janar të vitit 2017, pasi kishin krijuar dyshime për favorizimin e një të dënuari, kundrejt kërkimit dhe marrjes së përfitimeve monetare të



Gjyqtari i Gjykatës së Apelit në Tiranë, Shkëlqim Miri

### 'LISTA E ZEZË'

Bazuar në mbi 3 mijë denoncime online, kryeministri Edi Rama publikoi më 12 korrik të këtij viti një raport në faqen e tij në 'Facebook' me 100 zyrtarët që kanë abuzuar në administratën e shtetit. Një ndër emrat e "listës së zezë" të Ramës është dhe gjyqtari Shkëlqim Miri.

## Vrasja e dyfishtë, Doda u lirua pas 5 vitesh burg

# Përplasjet mes fiseve në qytetin e Burrelit, 16 persona të vrarë në 20 vite

TIRANË - Gentian Doda, u ekstradua nga SHBA në vitin 2012, i akuzuar për vrasjen e Gazmir Dedjas dhe Asllan Gjakës, ngjarje e ndodhur në tetor të vitit 1997. Doda dhe viktimja Gazmir Dedja kanë qenë anëtarë të grupeve rivale në Burrel, konfliktin ndërmjet të cilëve ka vijuar për shumë vite dhe me shumë viktimë. Sipas prokurorisë, nga hetimi i çështjes ka rezultuar se nga viti 1997 e në vazhdim shkaku i konfliktit me pasojat të rënda ka qenë përplasia e vazhdueshme ndërmjet dy familjeve. Nga hasmëritë mes dy fiseve në Mat numërohen të vrarë të paktën 16 persona që prej vitit 1997 e në vazhdim. Në vitin 2010, në Tiranë është vrarë edhe vëllai i viktimës, Halil Dedja, i cili u



Burreli

ndërkombëtar të lëshuar nga autoritetet shqiptare. Pas ekstradimit, i akuzuar kërkoi rivendosjen në afat dhe rishikim të dënimit të dhënë më parë ndaj tij për këtë veprë penale. Ndonëse vrau dy persona në 97-ën, Gentian Doda fitoi lirinë vetëm pas 5 vitesh burg

paligjshme. Bëhet fjalë për Gentian Dodën, i cili ekzekutoi në tetor të vitit 1997 dy persona në qytetin e Burrelit. 46-vjeçari Miri akuzohet se ka marrë një shumë prej 20 mijë eurosh duke ndryshuar veprën penale për Gentian Dodën, nga vrasje me dashje në plagosje të rëndë, duke e liruar nga burg. "Në këtë operacion, në bazë të dyshimeve të bazuara në provat e siguruar gjatë hetimit pro-aktiv janë

dokumentuar një sërë veprimesh dhe lidhshje të dyshimta që me marrjen e këtij vendimi, gjyqtari Miri ka marrë një sasi të konsiderueshme parash", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë. Pas vendimit të marrë nga gjyqtari Shkëlqim Miri, i dënuari Gentian Doda arriti të fitojë lirinë. Doda tashmë është shpallur në kërkim jo vetëm për vrasjen e dyfishtë në 97-ën, por edhe për akuzën e korrupsionit.

Ende nuk ka informacion për vendndodhjen e 37-vjeçarit, por zyrtarisht nuk rezultojnë që një person me gjeneralitete të tilla të ketë dalë nga Shqipëria.

### GJYQTARI

Pas ndalimit nga blutë e kryeqytetit me urdhër të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, "GSH" ka mundur të zbardhë dëshminë e gjyqtarit Shkëlqim Miri. Gjatë marrjes në pyetje, ai ka thënë se vetëm një pjesë e



## Të ardhurat "modeste" të gjyqtarit Miri, deklarimi i pasurisë në vitin 2014

TIRANË - Gjyqtari i gjykatës së Apelit në Tiranë, Shkëlqim Miri është ndaluar mbrëmjen e së enjtes, me kërkesë të Prokurorisë së Krimeve të Rënda. Gjatë kontrollit në banesë atij iu gjetën 300 milionë lekë të vjetra që dyshohet të jenë marrë në këmbim të një vendimi favorizues për autorin e një vrasje të dyfishtë të ndodhur në Burrel në vitin 1997. Por nga një verifikim në portalin e deklarimit të pasurisë, bie në sy fakti se gjyqtari ka deklaruar një pagë dhe pasuri modeste dhe nuk justifikohet shumica e parave të gjetura në banesë me deklarimin e pasurisë që ka bërë deri në vitin 2014. Ai ka deklaruar një banesë afro 50 metra katrorë, 4 milionë lekë të vjetra kursime në bankë si dhe 1 349 625 lekë të ardhura nga paga e tij. Gjithashtu ai rezultoi se ka marrë edhe një kredi në një bankë të nivelit të dytë në shumën 50 mijë euro dhe me normë interesi rreth 4% si dhe me detyrim financiar të paslyer 39 953 euro. Gjyqtari rezultoi pa makinë dhe pa pasuri të tjera.



parave ishin të tij (rreth 3 mln lekë), ndërsa pjesa tjetër ishte e një të afërmi të tij, i cili do të blinte një pronë në Tiranë. "Rreth 3 milionë lekë janë të miat, pjesa tjetër të një të afërmi, i cili m'i kishte lënë, sepse do blinte një pronë të Tiranë. Kursimet i kisha nga pagat dhe i mbaja në shtëpi", është shprehur gjyqtari. Shkëlqim Miri është marrë në pyetje nga prokurori Klodjan Braho dhe dy oficerë të policisë gjyqësore në prani të avokatit të tij, Ardian Visha. Seanca për vendosjen e masës së sigurisë ndaj gjyqtarit Miri priten të zhvillohet para ditën e të dielës. 46-vjeçari, i cili u ndalua nga policia për shpërdorim detyre dhe korrupsion, rrezikon të dënohet

deri në 4 vite burg. "Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parrëgjull, për vete ose për personë të tjerë, gjyqtari, prokurorit ose çdo punonjësi tjetër të organeve të drejtësisë, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën e funksionit e tij, dënohet me burgim nga një vit deri në katër vjet dhe me gjobë nga katërqind mijë deri në dy milionë lekë", thuhet në nenin 319. Shkëlqim Miri ka një karrierë 25-vjeçare në drejtësi, që nga gjyqtari i Shkallës së Parë, më tej gjyqtar Apeli në Durrës, anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë nga 2007 në 2011-ën dhe së fundmi gjyqtar i Apelit në Tiranë.



**MAT** - Një vit më parë, kohë kur kishte nisur rigjykimi i çështjes së Gentian Dodës në gjykatën e Matit, nëna e Gazmir Dedjas i ka dërguar një letër Prokurorit të Përgjithshëm, ministrit të Drejtësisë, prokurorisë së Matit dhe gjykatës së këtij rrethi, ku kërkon drejtësi për djalin e vranë. Xhevrje Dedja akuzon familjen Doda, konkretisht Admir dhe Gentjan Doda për vrasjen edhe të dy djemve të tjerë dhe bashkëshortit. "Unë Xhevrje Dedja, banuese në Mat jam bashkëshortja e të ndjerit Fehmi Dedja dhe nëna e tre djemve të ndjerë: Gëzim, Halit dhe Gazmir Dedja, të gjithë këta tashmë të vranë për hakmarrje, xhelozji dhe inate nga dora dhe urdhrat e kësaj bande kriminale të përbërë nga vëllezërit Admir dhe Gentjan Doda si dhe bashkëpunëtorët e të rekrutuar prej tyre", shkruante 76-vjeçarja duke kërkuar drejtësi për djemtë e saj të vranë, duke

## "Dua vetëm drejtësi për familjarët e mi! Nëna e Gazmir Dedjas, letër kryeprokurorit: Tre djem mu vranë nga dora e vëllezërve Doda



Prokuroria e Përgjithshme

shtuar se ishte në dijeni se në gjykatën e Matit po rigjykohej çështja ndaj Gentian Dodës. Në letrën drejtuar krerëve të drejtësisë, ajo shkruante se vëllezërit Doda akuzohen edhe për krime të kryera në Britani ku dhe i vëllai i tij po vuan dënimin për krime të ndryshme që kanë kryer në këtë shtet.

"Duket qartë se vëllezërit Doda e vazhduan aktivitetin e tyre kriminal edhe jashtë Shqipërisë duke treguar kështu rrezikshmërinë e tyre kriminale jo vetëm për ne, por për të gjithë shoqërinë dhe shtetin", shkruante e moshuara. Ndërkaq, Xhevrje Dedja thoshte se Gentian Doda po akuzohet

për vrasjen e djalit të saj Gazmir Dedja dhe një qytetari tjetër të quajtur Asllan Gjoka. "Unë personalisht kam dhënë shpjegime dhe kam provuar me fakte për këtë vrasje në prokurorinë e rrethit dhe komisariatin e policisë Mat. Tani nuk ka më alibi për krimin që ka kryer ky vrasës, sepse ka kërkuar gjykim të shkurtuar", shkruante 76-vjeçarja. Ajo e mbyllte letrën e saj me kërkesën për drejtësi si nënë e vuajtur që shprejon dhe beson te institucionet e drejtësisë. "Dua vetëm drejtësi për familjarët e mi", shkruante e moshuara. Por, pas rigjykimit të çështjes, Gentian Doda u dënua me 8 vjet burg dhe doli 2 muaj më parë nga qelia.

**SHKURT**

**Sherr me thika, vritet në qendër të**

**qytetit 16-vjeçari**  
**KUKËS** - Një 16-vjeçar nga Kukësi është vrarë mbrëmë me thikë në qendër të këtij qyteti. Burime nga policia lokale bënë me dije se në sherr e sipër, minoreni A.M. është goditur për vdekje nga 17-vjeçari R.M.. I plagosuri është transportuar urgjentisht në spitalin e Kukësit, por pavarësisht ndihmës së dhënë nga mjekët, ai nuk ka mundur t'i mbijetojë vdekjes. Falë veprimeve të shpejta, blutë bënë të mundur vënien në pranga të autorit të dyshuar. Adolshenti R.M. është shoqëruar me komisaratin e policisë për veprime mjekësore. Gjithashtu, është gjetur dhe sekuestruar thika e dyshuar si e përdorur nga autori. Ndërkaq, grupi hetimor po punon intensivisht për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes.

**Dozja 'Habibaj', zgjatet me 20 ditë masa e arrestit për Seitin**

**TIRANË** - Gjykata e Tiranës ka zgjatuar me 20 ditë afatin e masës së sigurisë për qëllime ekstradimi të Nezar Seitit, i arrestuar si pjesë e dosjes hetimore "Habibaj". Mësohet se ka qenë prokuroria që kërkoi zgjatjen e qëndrimit në burg me 60 ditë, kërkesa u pranua pjesërisht nga togat e zezë. Nazer Seiti, njëri nga njerëzit e konsideruar nga prokuroria e Katanis në Itali, si anëtar i bandës së drejtuar nga Moisi Habibaj u arrestua në Babicë të Vlorës, aksion në të cilin u kapën 4 tonë drogë.

**U nis me traget drejt Italisë, zhduket**

**avokati Besnik Muço**  
**ITALI** - Avokati shqiptar Besnik Muço rezultoi i zhdukur që prej datës 2 nëntor. Sipas mediave italiane ai duhet të takohet me gruan e tij në Macerata të Italisë, por që prej atij momenti nuk dihet më asgjë për të. Avokati 54-vjeçar u nis më 2 nëntor, por që nga ajo ditë, humbi gjurmët dhe menjëherë gruaja e tij, Raimonda shkoi në polici për të bërë denoncimin. Në këtë datë ai duhet të kish të hipur në traget në portin e Durrësit dhe t'i drejtohej me pas Barit të Italisë. Por, "i Messenger" shkruan se ai nuk mbërriti kurrë në portin italian. Asnjë telefonatë në shtëpi dhe celulari i tij rezultoi i fikur. Gruaja e tij e shqetësuar vendosi javën e kaluar të kërkojë ndihmë në organet e zbatimit të ligjit. Policia po punon për të zbuluar se cilat ish-in kontaktet e fundit të Muços si dhe për gjetjen e tij.

Vendimet e dhëna ndaj ekzekutorit nga Gjykata e Shkallës së Parë deri në Kushtetuese

# Ngjarja e 97-ës në Burrel, ja si i shpëtoi Gentian Doda akuzës 'Vrasje me paramendim'

Gjykata e Matit e dënoi me 8 vjet burg për plagosje të rëndë

Klodiana Lala

**TIRANË**

Në shtator të vitit 2016, pas një përballje të gjatë me drejtësinë, Gentian Doda, i akuzuar për vrasjen e Gazmir Dedjas dhe Asllan Gjokës në tetor të vitit 1997 në Burrel, mori lajmin e mirë nga gjykata e Matit, pasi iu hap rruga për të lënë qelitë e burgut. "News24" dhe "GSH" ka siguruar dje vendimin e plotë të dhënë ndaj tij nga gjykata e Matit. Një treshe gjyquese e kryesuar nga Ali Koleci firmosi për rrëzimin e akuzës së vrasjes me paramendim që rëndonte mbi supet e Dodës dhe dënoi atë me 8 vjet burgim për plagosje të rëndë me pasojë vdekjen.



Gentian Doda

minuta përpara atentatit Gazmir Dedja, ishte takuar me të vëllain e tij, Halitin, i cili e kishte këshilluar të kishte kujdes, pasi një makinë e zezë tip "Benz" me targa të Durrësit, po vinte vërdallë. Nuk vonoi dhe dikush e thërritë viktimën: "O Gaz, o Gaz" dhe një person që ndodhej në makinë qëlloi në drejtim të tij me kallashnikov. Në këtë moment arsyetën gjykata-Gazmir Dedja thërret "Më vranë o Halit!". I vëllai e dërgon drejt spitalit dhe duke qenë se ishte në gjendje, Gazmiri u tregoi të gjithë të afërmit, babait, nënës, dhe gruas së ndaj tij qëlloi Gentian Doda.

Pasi pranon këto fakte, gjykata arsyetën se sipas aktit të ekspertimit mjeko-ligjor nr.62 datë 27.10.1997 thuhet se

dëmtimet e konstatuara tek viktima Gazmir Dedja, hyjnë në kategorinë e plagosjes së rëndë. Për Asllan Gjokën, ekspertët mjeko-ligjorë kanë arritur në konkluzionin se te viktima vërehen dëmtime/plagë të shkaktuara me armë zjarri, por shkaku i vdekjes është shoku i rëndë traumatik e hemoragjik. Në këto kushtetuhet në vendim-gjykata çmon se ndodhemi përpara veprës penale të "Plagosjes së rëndë me dashje", me pasojë vdekjen, kjo edhe për faktin se në asnjë nga deklaratimet e dëshmitarëve të afërm të Dedjas, nuk provohet që midis të pandehurit dhe viktimës të ketë pasur konflikte para kësaj ngjarje, ç'ka do të çonte në akuzën e vrasjes me paramendim. Veprimet e të pandehurit plotësojnë elementet e veprës penale të "plagosjes së rëndë" me pasojë vdekjen, ashtu siç është përcaktuar në aktin e ekspertimit mjeko-ligjor, ku përcaktohet se dëmtimet e konstatuara tek Gazmir Dedja hyjnë në kategorinë e plagosjes së rëndë. Dhe për këtë veprë i pandehuri Gentian Doda duhet të deklarohet fajtor dhe të dënohet. Sa i përket akuzës së armëmbajtjes pa leje, i pande-

**SAGA E PROCESEVE GJYQËSORE NDAJ DODËS**

1. Gentian Doda u hetua dhe dënua për vrasjen e Gazmir Dedja mesditën e 27 tetor të vitit 1997. Për këtë vrasje ai u dënua me 4 vite më pas më 26 janar 2001 me 20 vite burgim.
2. Disa muaj më pas Doda apelon vendimin, por gjykata e apelit lë në fuqi 20 vitet e burgut duke mos pranuar ankimin e tij.
3. Më 2 shkurt 2002 po e njëjta gjykatë, Apeli i Tiranës lë në fuqi dënimin me 20 vite burg në mungesë të dhënë nga gjykata e Matit
4. Në vitin 2012, Gentian Doda ekstradohet nga SHBA-të, ku u arrestua në Kaliforni për llogarit të drejtësisë shqiptare dhe kërkon rigjykim të çështjes.
5. Në vitin 2013, Gjykata e Lartë rrezoi kërkesën duke lënë në fuqi dënimin me 20 vite burg. Por, Doda nuk hoqi dorë, duke e çuar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.
6. Kjo e fundit e riktheu çështjen në Gjykatën e Lartë, e cila këtë herë pranoi kërkesën e autorit të dyshuar të dy vrasjeve për rishqyrtim të çështjes. Për më tepër Gjykata e Lartë urdhëroi rigjykim në Gjykatën e Matit në vitin 2015 me një tjetër trupë gjyquese nga e hera e parë për Dodën.
7. Në shtator të vitit 2016, Gjykata e Matit dha vendimin me 8 vjet burg për Gentian Dodën, i cili sërisht nuk ishte i kënaqur dhe apeli vendimin. Gjykata e Apelit ndryshoi akuzën, në 'plagosje me dashje'. Por kjo gjë është kundërshtuar nga organi i akuzës. Më 10 korrik 2017, Prokuroria e Apelit bëri rekurs në Gjykatën e Lartë, duke kërkuar prishjen e 2 vendimeve të mëparshme përfshi vendimin e gjyqarit Shkëlqim Miri dhe dënimin me 20 vjet burg për vrasje.

huri nuk duhet të dënohet, pasi autoritetet amerikane të drejtësisë kanë komunikuar miratimin e ekstradimit të Dodës vetëm për akuzën e "vrasjes me paramendim". Ky vendim i gjykatës së Matit u la në fuqi edhe nga

tresha gjyquese e Apelit e kryesuar nga Shkëlqim Miri, i cili ka përfunduar tashmë në pranga pas dyshimeve për korrupsion. Në të dyja shkallët e gjyqësorit prokuroria ka kërkuar dënimin e 39-vjeçarit me 20 vite burgim.

# "DITET E MEDIAS" PËRPLASJA

Valentina Madani

Kreu i PD, Lulzim Basha reagoi ashpër dje ndaj deklaratave të kryeministrit Edi Rama në konferencën "Ditët e Medias". Sipas Bashës, Rama krijon klimë që inkurajon kriminelët të sulmojnë gazetaret. Z.Basha risolli në vëmendje edhe rastin e një gazetares, që u vra disa ditë më parë në Maltë, teksa ajo po hetonte kryeministrin e vendit të saj. Ai tha se fjalimi i djeshëm i Ramës kundër gazetarëve është një fjalim kriminal. Me fjalime të tilla, ai është duke nxitur përditë urrejtjen dhe dhunën ndaj gazetarëve. Gazetarët janë ndër njerëzit më të rrezikuar në botë, shënjestër e shpesh të krim-it dhe e politikanëve të korruptuar. Vetëm pak ditë më parë në Maltë u vra në mënyrë barbare një gazetares që hetonte kryeministrin", tha z.Basha. Ai akuzoi se: "Klima që krijon Edi Rama inkurajon pikërisht kriminelët që të sulmojnë gazetaret, të cilët raportojnë e hetojnë krimin dhe korrupsionin. Njeriu që ka thurur vetëm lavde dhe përkëdhell për Elvis Roshin, Saimir Tahirin dhe kriminelët e tjerë me të cilët rrethohet, duhet të ndalë menjëherë gjuhën e tij të rrezikshme". Kreu i PD-së u bëri thirrje "të gjithë qytetarëve, intelektualëve, gazetarëve dhe politikanëve ta denoncojnë dhe të mos heshtin përballë kësaj sjelljeje kriminale të kryeministrit". Kryeministri Rama i ka kthyer përgjigje Lulzim Bashës, i cili i quajti kriminale fjalimet e tij. "L.B ishe ti apo isha unë në cadër, kur ulërive të gjitha mediat janë të kapura nga droga, përveç një kanali TV", të cilin ia rekomandoje publikut si burim të kulluar?! Unë kurrë s'e kam imagjinuar, jo më ta them një veshëgjatllëk të tillë. Është thjesht shpifje! Prandaj kërkoju falje njëherë të gjitha mediave (përveç njërës) që i kriminalizove me baltën e çadrës për muaj të tërë, ditë për ditë, pastaj fol sa të duash për rrezikun që u vjen nga fjalët e mia. Po mos e harro, unë kam jetuar me ta, kam punuar me ta, kam ngrënë kopacë kokës e më ka dalë edhe gjak për lirinë e fjalës bashkë me ta. Apo s'e mban mend?! Kështu që nga unë e nga fjalët e mia dje, sot e mot, atyre mund t'u dalë më shumë vrer nga goja kundër meje e qeverisë sime, po kurrë nuk u ka hyrë, nuk u hyn e nuk t'u hyjë një gjemb në këmbë. Kurrë! Por natyrisht, gojë s'kanë vetëm ata

Përplasia për gazetarët, kryeministri: Po ribëhesh qesharak. Kreu i PD: Censurues

## Rama: Hëngra dru për fjalën e lirë. Basha: Po inkurajon kriminelët

"Autokrat i zhytur në korrupsion, drogë dhe krim"



Kryeministri Edi Rama dhe kreu i opozitës, Lulzim Basha

### EDI RAMA

"Njerëzit duhet të dëgjojnë edhe anën time e pastaj gjykojnë vetë ata, mos e ki merak. Sepse, mos e harro, ta kam thënë shpesh në publik, por edhe sy më sy se kush i merr shqiptarët për budallenj e pëson dhe sa më shumë t'i bëjë për budallenj, aq më keq e pëson! Çudi e madhe me ty o mik, që nuk mëson", tha z.Rama.

### LULZIM BASHA

"Klima që krijon Rama inkurajon kriminelët që të sulmojnë gazetaret, të cilët raportojnë dhe hetojnë krimin dhe korrupsionin. Rama si një censurues i dobët shtrembëron qëndrimet e mija për mediat. Ka pasur dhe do të ketë kritika për ata pronarë që s'lejojnë gazetaret të raportojnë të vërtetën", tha Basha.



Komisioneri i BE-së për Zgjerimin, Johannes Hahn, dje me kreun e opozitës Lulzim Basha

### DENONCIMI, BERISHA: NË MAKINËN E SOTËS ISHIN 4 VETA

Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje një tjetër denoncim të qytetarit dixhital, i cili shkruan për rastin e biznesmenit të ndaluar në Elbasan. Berisha shkruan se në makinën e biznesmenit, në momentin e ngjarjes ndodheshin 4 persona dhe jo dy siç, u tha nga policia. Ai thotë se bashkë me të në makinë ishin edhe Florian Habilaj dhe shoferi i Saimir Tahirit. Ai shprehet se, "këta të dy kanë marrë me vete, para syve të policisë, çantat që përmbanin mbi 3/4 e eurove në makinë dhe se Xhafa-Çako janë shpërblyer shumë rëndë për fshehjen e këtij rrëmbimi". Berisha shkruan se, "një çantat plot euro ka përfunduar në zyrë të Noriegës".

### Mblidhet Komisioni për Reformën Zgjedhore

## PS, Çuçi: Pati shitblerje vote. Bylykbashi: I vodhët zgjedhjet

Deputetët e opozitës dhe OSBE-së bashkuan votat me konsensus për përbërjen e Komisionit për Reformën Zgjedhore, që dje u mblodh për herë të parë për konstituimin e tij. Kreu i Kuvendit, Ruçi tha se zgjedhjet janë me rëndësi për cilësinë e demokracisë dhe komisioni do mbështet në rekomandimet e OSBE-ODHIR. Ndërkohë, Bylykbashi u shpreh se duhet vullnet politik për reformën dhe sipas tij, rekomandimi prioritar i OSBE-së është çështja e shitblerjes së votës. Ai kërkoi realizimin e votimit dhe



numërimin elektronik. "Vullneti politik është themel për reformën. Raporti tregon se si u fituan zgjedhjet e kaluara. Rekomandimi prioritar i OSBE është çështja e shitblerjes së votës. Të realizohet votimi e numërimi elektron-

ik. Votimi me postë i emigrantëve është qesharak", - theksoi z.Bylykbashi. Edhe bashkëkryetari Bledi Çuçi theksoi se ndërkombëtarët folën qartë para dhe pas 25 qershorit, ndërsa i cilësoi zgjedhjet si më të qetat të realizuara paskomuniste. Çuçi foli edhe për problemin e evidentuar në raportin e OSBE/ODHIR, siç është shitblerja e votës. "Edhe unë jam i shqetësuar për rekomandimin e OSBE/OHDIR, që lidhet me blerjen e votës, që ka kaluar në rend parësor, për këtë jam i shqetësuar dhe unë", tha Çuçi.

dhe gojë time e kam pasur; e kam dhe do ta kem sa të kem frymë, për të vërtetat e mia, që nuk i negocioj e as i kyç në heshtjen hipokrite të me demokracisë për me-

dian!", shprehet z.Rama. Akuzave në distancë për debatin mbi mediat, kreu i PD-së u ktheu sërish përgjigje. Basha theksoi se Rama është censurues i

dobët, shtrembëron qëndrimet e tij. Kreu i PD-së e cilësoi kreun e qeverisë një autokrat të zhytur në korrupsion, drogë dhe krim.



### Noka i hedh tutje mikrofonin Felajt

## Debat i ashpër, flysh sherrri te Komisioni i Sigurisë

Mbledhja e djeshme e Komisionit kuvendor të Sigurisë pati një tjetër përplasje mes demokratit Flamur Noka dhe kryetares së komisionit, Ermonele Felaj. Kryetarja e komisionit, Ermonele Felaj nuk i ka dhënë fjalën deputetit demokrat Flamur Noka dhe ky është bëtë shkak për plasjen e sherrit të radhës. Noka, në nervozizëm e sipër i merr mikrofonin Felajt dhe ia hedh tutje. Efektivi i Gardës është vënë shpejt në lëvizje, ndërkohë që opozita pas sherrit braktisi mbledhjen e komisionit.

### DEBATI MES NOKËS DHE FELAJT

**ERMONELA FELAJ:** Nuk ke të drejtë të flysh asnjë anëtar të komisionit, përshirë edhe mua.

**FLAMUR NOKA:** Në rast se s'kupton, dil e mëso. Ermonele Felaj: Do t'i drejtohem kryetarit të Kuvendit të të përjashtojë.

**FLAMUR NOKA:** Drejtohu kujt të duash, edhe kryeministrit po deshe, ose mëso si drejtohet, ose dil përjashta.

**ERMONELA FELAJ:** Dakord? Me fyerjet po fyen intelligencën e të gjithëve, mediat edhe publikun.

**FLAMUR NOKA:** Deputetët po trajtohen si nxënës të klasës së 5. Merrren dhe çohen neperi institucione. Mos u poshtëroni në këtë mënyrë. Është e turpshme t'i trajtohet deputetët si nxënës. Mëso të drejtosh, ose ik fare.

**ERMONELA FELAJ:** Shumë mirë që ico, edhe kur ico, e do mikrofonin ndezur.



Darina Tanushi

Komisioneri i BE-së për Zgjerimin, Johannes Hahn u prit dje, nga Presidenti i Republikës, Ilir Meta pritë. Presidenti Meta mirëpriti zhvillimin e konferencës "Ditë e Medias BE-Balkani Perëndimor", që po zhvillohet në Tiranë, duke iu bashkuar mesazhit të Komisionerit Hahn se liria e shprehjes është një vlerë themelore dhe nxitëse e fuqishme e transformimit demokratik. Presidenti i Republikës theksoi se Shqipëria e konsideron anëtarësimin në BE një projekt kombëtar strategjik, që meriton të gjithë angazhimin institucionial dhe qytetar për plotësimin e 5 prioritetëve, zbatimin e të cilave do të sjellë çeljen e negociatave të anëtarësimit. Presidenti Meta vlerësoi se lufta e pa kompromis kundër krimit të organizuar dhe zbatimi i reformës në drejtësi duhet të njohin hapa të shpejtë e cilësorë përpara, jo vetëm në funksion të vendimit për çeljen e negociatave të anëtarësimit, por edhe në një plan afatgjatë për forcimin e sundimit të ligjit në vend. Duke vlerësuar investimin e madh të BE dhe SHBA në reformën në drejtësi, Presidenti Meta vuri në dukje rëndësinë jetike që ka zbatimi i qenësishëm i saj. Ai kërkoi vëmendjen e posaçme të ekspertëve të EURALIUS që asistojnë në këtë proces, për interpretimin e saktë të legjislativimit në interes të krijimit sa më të shpejtë e të besueshëm të institucioneve të reja të drejtësisë. Presidenti Meta dhe Komisioneri Hahn diskutuan edhe mbi zhvillimet në rajon, ku u theksua rëndësia që ka angazhimi i shtuar i BE-së për përshpejtimin e proceseve demokratizuese dhe integruarëve të drejtësisë të vendëve të Ballkanit Perëndimor. Presidenti Meta theksoi rëndësinë jetike të anëtarësimit sa më të shpejtë të Maqedonisë në NATO, me bindjen se do të gjenerojë më shumë siguri për të gjithë rajonin, si dhe domosdoshmërinë e liberalizimit të shpejtë të vizave për Kosovën.

**OPOZITA**  
Po, dje, Komisioneri Hahn bisedoi edhe me dy liderët e opozitës, kreun e PD-së, Lulzim Basha e kryetaren e LSI-së, Monika Kryemadhi. Në bashkëbisedimin e gjatë mes

Presidenti pret Komisionerin e Zgjerimit, takime edhe me kreut e opozitës

# Meta-Hahn: Hapa më të shpejtë për luftën kundër krimit dhe reformën në drejtësi

## Opozita: Situata e rëndë, por të hapen negociatat



Komisioneri i BE-së për Zgjerimin, Johannes Hahn, dje me Presidentin Ilir Meta


### DEKLARATA E HAHN

"Pres që progresi i raportit për Shqipërinë, që do të dalë në prill të vitit të ardhshëm, të jetë pozitiv. Nuk ka feedback negativ për Shqipërinë prej asnjërit nga vendet anëtare. Por Shqipëria duhet të zgjidhë problemin e azilkruesve në vendet e BE, pasi ai dëmton reputacionin e Shqipërisë në opinionin publik të vendeve anëtare", - tha dje, për "DV", Komisioneri Hahn.

tyre një vend të rëndësishëm zuri situata aktuale politike pas publikimit të provave për përfshirjen në trafik ndërkombëtar narkotikësh të bashkëpunëtorëve të afert të kryeministrit Rama, përfshirë ish - ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri. Basha dhe Hahn ndanë të njëjtin mendim se integrimi evropian i Shqipërisë duhet të jetë i bazuar në meritë dhe se vendi ka nevojë për prova të forta të zbatimit të paanshëm të reformës në drejtësi. Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, gjithashtu, i parashtroi Komisionerit faktet për situatën e rënduar politike, ekonomike dhe sociale, ku theksi është vendosur të influenca direkte e krimit të organizuar në zgjedhjet e 25 qershorit, si dhe aktualisht në instancat shtetërore apo në qeverisje. Kryetarja e LSI kërkoi nga Bashkimi Evropian hapjen sa më të shpejtë të negociatave, si garanci për të luftuar bashkërisht krimin, drogën dhe korrupsionin qeveritar, për të rikthyer stabilitetin, ringritjen e shtetit të së drejtësisë dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

### Droga, Meta refuzon kërkesën e 7 deputetëve të PD-LSI: Mbledhja sekrete

Presidenti Ilir Meta i ktheu përgjigje negative kërkesës së 7 deputetëve të PD-së dhe të LSI-së për deklasifikimin e mbledhjes së Këshillit Sigurisë Kombëtare të 11 nëntorit të vitit të kaluar ku u diskutua për kanabisin. Meta në përgjigjen drejtuar deputetëve sqaron se nuk e deklasifikon mbledhjen sekrete, pasi është në kundërshtim me ligjin. "Nëpërmjet kësaj përgjigje ju bëj me dije se nuk e kam aprovuar kërkesën tuaj. Vlerësoj se deklasifikimi dhe publikimi i diskutimeve në mbledhjet e KSK-së (që nuk ka ndodhur asnjëherë) do të përbënte një precedent me pasojë afatgjatë për funksionimin e Këshillit të Sigurisë Kombëtare. Institucioni i Prokurorit të Përgjithshëm mundet të kërkojë dhe të përdorë për interesa të hetimit informacionin e mbledhjet të KSK-së në mënyrën e përcaktuar nga ligji", - u shpreh Meta në letrën drejtuar deputetëve.



Negociatat do të vijojnë sot për të gjitha çështjet

## Bushati-Kotzias, 12 orë diskutime në Kretë për detin e ligjin e luftës

Dy ministrat e Jashtëm të Shqipërisë dhe Greqisë, përkatësisht Ditmir Bushati e Nikos Kotzias përfunduan ditën e parë të bisedimeve në Kretë të Greqisë. Takimi përfundoi në orët e vona të mbrëmjes dhe ka zgjatuar për më shumë se 12 orë. Me mbi 300 faqe material nga arkivi i MPJ dhe Arkivit të Shtetit, dokumente historike, harta të të gjitha natyrave dhe një ekspertizë shteruese në tavolinë, pala shqiptare tregoi se e ka marrë me shumë seriozitet takimin. Kjo është hera e parë që palët po diskutojnë çdo pikë në detaje, për ato që quhen çështje të reja dhe historike mes dy vendeve. Klima pozitive mes palëve, por edhe dëshira për mbylljen përfundimtare të një sërë problemesh që prekin marrëdhëniet dypalëshe, duket se është edhe çelësi i zgjidhjes për disa prej temave, për të cilat dy ministrat nuk kanë dashur të publikojnë detajet. Burime të larta diplomatike greke i thanë "Top Channel" se në tryezën e bisedimeve janë hedhur të gjitha temat dhe ditët në vazhdim priten rezultatet konkrete. Gjatë mbrëmjes diskutimet u spostuan në një restorant, ku dy delegacionet kanë patur një darkë pune. Gjatë paradites së sotme pritët të diskutohen edhe temat e tjera të mbetura, siç është ligji i luftës dhe zonat e minoritetit.

Studio Permbarrimore "SHKRELA" do të zhvillojë Ankandin e pare për pasurinë:  
"Apartament" me sipërfaqe 53.8 m<sup>2</sup>, me nr. Pasurie 2/189+13-135, Vol. 12, Fq. 125, Zona Kadastrale 8120, e ndodhur ne Rr. "Shyqyri Peza", Pall. 6, Shk. 13, Ap. 135, Tirane, ne pronesi te bashkepronareve Sina, dhe e hipotekuar ne favor te bankes.  
Cmimi me te cilin fillon shitja e kesaj pasurie eshte ne vleren 25,824 (njzete e pese mije e teteqind e njzete e kater) Euro  
Ankandi i pare zhvillohet me date 17.11.2017, ora 16:00 ne ambientet e Studios Permbarrimore Shkrela me Adrese: Rruga Blv. "Zogu i I", Pall. "Agimi", H 2, K 3, Ap. 5, Tirane.

## REPUBLIKA E SHQIPERISE BANKA E SHQIPERISE DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT SEKTORI I PROKURIMIT TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje e disa pajisjeve pune për përpunimin e parasë dhe letër fashetimi e shirit plastik për nevojat e Bankës së Shqipërisë".

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit **5,680,000 Lekë**. Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraparakisht pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje e disa pajisjeve pune për përpunimin e parasë dhe letër fashetimi e shirit plastik për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **05 Dhjetor 2017, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Qeveria miraton datën 31 korrik 2018, si limit për kalimin e pronësisë

NISMA E LSI

Qeveria i jep mendim Kuvendit për statusin e minatorit

Qeveria vendosi dje, t'i japë mendimin e saj. Kuvendit për ligjin e propozuar nga LSI për statusin e minatorit. Një prej vendimeve të dje-shme në mbledhjen e Dibrës ishte pikërisht ky. Sipas vendimit në mbështetje të neneve 82, pika 2, dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin e kryeministrit, Këshilli i Ministrave vendosi: Dhënie e mendimit Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për projektligjin "Për statusin e minatorit", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi. Ky projektligj mbi statusin e minatorit i propozuar që në legjislaturën e kaluar nga deputeti i Lëvizjes Socialiste për Integrim Përparim Spahiu, synon të rrisë pagën minimale për këtë kategori dhe të ulë vite e daljes në pension. Projektligji parashikon edhe rritjen e mbështjtes sociale për minatorët dhe ish-minatorët. Në industrinë e minierave në Shqipëri deri në vitet 90 kanë qenë të punësuar mbi 40 persona. Efektet financiare, sipas zotit Spahiu, do të përballohet nga shtimi i kontributeve dhe buxheti i shtetit. "Për çdo person do të paguhet kontribut shtesë në masën 5 për qind të pagës bruto për efekt kontributi. Kontributi shtesë do të paguhet në masën 2 për qind nga punëmarrësi dhe 3 për qind nga punëdhënësi", thuhet në këtë nismë.

# Vendimi/ Shtyhet afati për përfundimin e procesit të marrjes së tapive mbi tokën

Plotësimi i dokumentacionit do të kryhet nga bashkitë

Qeveria vendosi dje, në mbledhjen e saj shtyrjen e afatit të procedurave të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfutuesve deri më 31 korrik 2018. Ky vendim u mor dje, në mbledhjen që u zhvillua në qarkun e Dibrës, ndërkohë që është në konsultim publik prej kohësh. Ligji nr. 171/2014 "Për përfundimin e procedurave të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfutuesve", të ndryshuar, ka për qëllim përfundimin e procedurave ligjore të kalimit në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore përfutuesve sipas ligjit nr. 8053, datë 21.12.1995, "Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore", të ndryshuar, të cilët nuk kanë bërë kalimin në pronësi, sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara në këtë ligj. Procesi i plotësimit të dokumentacionit të pronësisë mbi tokën bujqësore kryhet nga bashkitë. Për rastet kur komisioni i ndarjes së tokës, ka ndarë tokën bujqësore, por nuk ka plotësuar aktet e marrjes së tokës në pronësi, ligji ngarkon kryetarët e bashkive, t'i plotësojnë ato, në përputhje me kriteret dhe procedurën e përcaktuar, ndërsa prefekti i Qarkut mbikëqyr realizimin e këtij procesi. Nga informacioni i



mbledhur nga prefektët e qarqeve dhe bashkitë deri më datë 10 tetor 2017 rezultoi se janë paraqitur 2300 kërkesa nga familjet bujqësore. Relacioni për projektligjin "Për disa ndryshime në ligjin nr.

171/2014, "Për përfundimin e procedurave të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfutuesve", i ndryshuar" Shumë bashki kanë proceduar me kërkesat e

**RRUGA E ARBRIT**  
Kryeministri Edi Rama lajmëroi dje, nga Dibra, ku u mbledh edhe Këshilli i Ministrave se sot prezantohet projekti përfundimtar i Rrugës së Arbrit, pas përzgjedhjes edhe të kompanisë nga Ministria e Infrastrukturës. "Ky është një zotim madhor për një aks që në këndvështrimin tonë nuk i takon thjesht Dibrës. Me ndërtimin e tij, Dibra bëhet de facto pjesë e metropolit", -tha dje, Rama.

pozituara për njohje pronësie nuk janë të plotësuara me dokumentacionin hartografik sipas kërkesave ligjore, apo ekzistojnë mospërputhje ndërmjet dokumentacionit ligjor dhe atij hartografik të paraqitur. Mungesa e këtij informacioni zyrtar nga ATP, e ka bllokuar vijimin dhe përfundimin e procesit nga bashkitë. Në këto kushte, në projektligjin e propozuar, parashikohet që kalimi i tokës bujqësore në pronësi të përfutuesve (familjeve bujqësore) të moskushtëzohet me konfirmimin e faktit nëse kjo sipërfaqe toke është ose jo, objekt kërkesë që shqyrtohet nga ATP. Një ndryshim i tillë nuk cenon të drejtën e subjekteve pretendues, që pas vendimit të ATP për njohjen e kësaj prone, të kompensohen sipas ligjit. Në këto kushte, me qëllim që procesi i nisur nga bashkitë të konkretizohet me plotësimin e AMTP-ve, propozohet që afati i përfundimit të këtij procesi të jetë data 31 korrik 2018. Ky afat është i mjaftueshëm për realizimin e gjithë procedurave të nevojshme që përcakton ligji, thuhet në një relacion të qeverisë. Nëse ky afat nuk do të shtyhet, pra procesi nuk përfundon në rrugë administrative, përfutuesit megjithëse kanë të drejtë t'i drejtohen organeve gjyqësore (kjo e drejtë është e parashikuar në ligj), procesi do të shtyhet edhe më tepër në kohë dhe do të shoqërohet edhe me kosto më të mëdha për përfutuesit.

**USAID**  
FROM THE AMERICAN PEOPLE  
**REQUEST FOR APPLICATIONS (FY17-RFP01-7106)**

Date issued: November 8<sup>th</sup>, 2017

Application Deadline: December 13<sup>th</sup>, 2017

**Project Background:** The USAID's Transparency in Health Engagement Project (herein referred to as the Project) is a two-year project (March 2017 to March 2019) with a goal to improve health services for Albanian citizens by focusing on fighting corruption and encouraging cooperation among selected independent government agencies, civil society organizations (CSOs) and media to urge for more responsible governance in the health sector.

The Project will work to strengthen capacities of three independent government agencies: the Albanian Supreme Audit Institution, the High Inspectorate for the Declaration and Audit of Assets and the Prevention of Conflicts of Interest, and the Ombudsman Office.

**Objective:** The Project is seeking to engage a company to support the development of the software for the Electronic Asset Declaration and Conflict of Interest System (EACIDS) as described in the Procurement documents.

The EACIDS will be developed for the High Inspectorate of Declaration and Audit of Assets and Conflict of Interest (HIDAACI), under the Technical Assistance plan provided by the Project.

**Application Package:** to receive the full application package please send an email to [urcalbania@urc-chs.com](mailto:urcalbania@urc-chs.com) with the reference **FY17-RFP01-7106** in the subject of your request (no fee applied), and include company name and information.

For more information contact Transparency in Health Engagement Project  
Rruga Barrikadave Nr. 9, H.9/1, ap.12 Tirana  
Tel: 042228945

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**

**NJOFTIM PËR LIÇENSIM**

Në zbatim të nenit 40, të Ligjit Nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", të nenit 18 të "Rregullave të Praktikës dhe Procedurave" të ERE-s, të nenit 10 të "Rregullores për Procedurat e Liçensimit Modifikimit, Transferimit të Plote/ të Pjesëshëm dhe Rinovimit të Liçensave", bëjmë me dije të gjithë personat, Istitucionet ose shoqëritë e interesuara se: shoqëria **"Prima Energy" sh.p.k.**, ka aplikuar në Entin Rregullator të Energjisë për tu liçensuar, në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike.

Me vendimin nr.185, datë 10.11.2017, Bordi i ERE-s, ka filluar procedurat e liçencimit të këtij subjekti në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike.

Të gjithë të interesuarit lidhur me këtë kërkesë, mund të paraqisin objeksionet e tyre, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së vendimit, pranë zyrate të ERE-s në adresën: Bulevardi "Barjam Curri"; Rruga: Viktor Eftimiu Tiranë.

Adresa: Bulevardi "Barjam Curri"  
Rruga: Viktor Eftimiu, Tirane  
E-mail: [ereal@ere.gov.al](mailto:ereal@ere.gov.al)

Tel/Fax: +355 42 22 963  
Tel: +355 42 69 590  
[www.ere.gov.al](http://www.ere.gov.al)

Ministri: Synohet ulja e borxhit me 2.8% në 2018, prioritet investimet publike

# Debate për borxhin/ Arben Ahmetaj: Tendanca në ulje. Opozita: Po e rrisni

## Deficiti për vitin 2018 planifikohet të jetë në nivelin 2.0% të PBB

Ornela Manjani

Qeveria do të ulë borxhin me 2.8 për qind vitin e ardhshëm. Deficiti buxhetor do të jetë në nivelin 2.0% të PBB. Shifrat u bënë të ditura nga ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj, i pranishëm në seancë, ku prezantoi parashikimin e treguesve kryesorë për vitin që do të vijë. Sipas ministrit Ahmetaj, do të synohet ulja e borxhit deri në 2021 me 60%. "Objektivi i qeverisë është të ulët borxhin me 2.8 për qind vitin e ardhshëm", - tha ministri. "Prej tri vitesh qeveria ka deklaruar se balanca primare tregon se qeveria nuk ka akumuluar borxh të ri publik. Balanca korrente 3.3 për qind pozitive", - ka bërë me dije Ahmetaj, i cili shtoi se prioritet i kësaj qeverie janë investimet publike. "Kemi reduktuar borxhin publik, por njëkohësisht kemi parashikuar se niveli i investimeve publike do të jetë në nivelin 5 për qind të PBB-së, duke respektuar dhe rregullin e artë fiskal të raportit investimeve publike me



Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj, gjatë seancës

huamarrjen. Huamarrja e brendshme do të vijojë të jetë burimi kryesor i financimit", - deklaroi Ahmetaj. Tri rreziqet që prezantoi ministri ishin rreziku nga financimi, normat e interesit dhe nga kursi i këmbimit.

Për t'u mbrojtur nga rreziku i fundit, ministri tha se do të menaxhohet duke mbajtur borxhin në valutë në nivele optimale, jo më shumë se 55% e totalit të borxhit. Diskutimet për deficitin, nivelin e borxhit dhe menaxhimin e fi-

nancave publike janë shqëruar me debate në Komisionin parlamentar të Ekonomisë dhe Financave. Gjatë prezantimit të zërit të borxhit dhe deficitit buxhetor, ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj, u shpreh se balanca primare pritet të shoqërohet edhe buxhetin e vitit të ardhshëm, çka do të thotë që qeveria nuk do të krijojë borxh të ri, por nuk la pa përmendur edhe risqet. Këtë e kanë kundërshtuar deputetët e opozitës. Sipas Jorida Tabakut, qeveria ka dështuar në menaxhimin e financave publike, ku gjatë viteve të fundit nuk ka rritur investimet, por borxhin publik. Në draft-buxhetin e vitit të ardhshëm, deficiti buxhetor është parashikuar në masën 32.3 miliardë lekë, ose 2 për qind e Prodhimit të Brendshëm Bruto.

Ndahen çmimet e gazetarisë ekonomike "Vangjush Gambeta"

### Merr çmim gazetarja e "News 24", Vjollca Kongjoni

Unioni i Gazetarëve Shqiptarë ndau sot çmimet "Vangjush Gambeta" për raportimin më të mirë ekonomik të botuar në Shqipëri, në Kosovë dhe Maqedoni gjatë vitit 2017, si dhe çmimet e karrierës në gazetari. Fituesit e çmimeve ishin: Evis Halili (Memedaliu) - Për shkrimin më të mirë ekonomik në shtypin e shkruar në Maqedoni, Vjollca Kongjoni - Emisionin më të mirë audioviziv në Shqipëri, Blerina Hoxha - Shkrimin më të mirë ekonomik në shtypin e shkruar në Shqipëri, Enis Veliu - Shkrimin më të mirë ekonomik në shtypin e shkruar në Kosovë. Çmimi reporterere e vitit shkoi për gazetaren Alma Çupi. Gjatë kësaj ceremonie u ndanë dhe çmimet e karrierës in memoriam. Këtë vit dy çmime shkuan për gazetarin Ramiz Kelmendi (pas vdekjes) dhe çmimi i karrierës për Shqipërinë shkoi për Andrea Stefanin (pas vdekjes). Ishte bashkëshortja e Andrea Stefanit, ajo e cila mori në dorëzim këtë çmim të akorduar nga UGSH, ndërkaq gjatë ceremonisë nuk i fshehu emocionet. Çmimi i Gazetarisë Ekonomike "Vangjush Gambeta" nisi që në vitin 2009 me mbështetjen e "Japan Tobacco International".

## SHPALLJE E VENDEVE VAKANTE PRANË INSTITUCIONIT TË KOMISIONERËVE PUBLIKË

Institucioni i Komisionerëve Publikë, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin e Kuvendit nr. 94/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikë dhe klasifikimit të pagave të personelit të institucioni i Komisionerëve Publikë", shpall vendet vakante për pozicionet:

### Specialist Financë/Buxheti (III-b)

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Ekonomi, Dega Financë.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në profesion.
- Të ketë njohuri në programet financiare si: Alpha/Financa 5 etj.

### Specialist i Burimeve Njerëzore (III-b)

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor".
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 4 vite përvojë pune në fushën e burimeve njerëzore.

### Specialist IT (III-b)

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor", Informatikë, Teknologji Informacioni etj.
- Të ketë të paktën 3 vite eksperience pune në fushën e teknologjisë së informacionit.
- Të ketë njohuri shumë të mira në administrimin e sistemeve si Active Directory, Outlook Mail Client
- Të ketë njohuri bazë mbi pajisjet e rrjetit dhe infrastrukturën e rrjetit.
- Të ketë njohuri bazë për panelet e administrimit të faqeve web (WordPress, Drupal, Joomla etj).
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

### Specialist Protokoll/Arkive (IV-b)

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor".
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

### 2 sekretare pranë Komisionerëve Publikë (kategoria e pagës sipas VKM nr. 187/2017)

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Bachelor".
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

- Të ketë njohuri shumë të mira të programeve kompjuterike Microsoft Office.
- Eksperienca në punë përbën avantazh.

### KUSHTE TË PËRGJITHSHME

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e nenit 6 të ligjit Nr. 84/2016 "Për Rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Kandidatët duhet të kenë aftësi për t'u përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së kërkesës dorazi nga aplikanti nga data 20 deri 24 Nëntor, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të Komisionerëve Publikë, në adresën: Godina e ish-Lidhjes së Shkrimtarëve, Rruga e Kavajës, Tiranë nga e Hëna në të Premte, ora: 12:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës pranë institucionit të Komisionerëve Publikë në adresën: Godina e ish Lidhjes së Shkrimtarëve, Rruga e Kavajës, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 27 Nëntor 2017 dhe të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga zyra postare. Institucioni i Komisionerëve Publikë do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar. Bashkëidhur me kërkesën, kandidati dorëzon të mbyllura në zarf, 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- Jetëshkrimin profesional përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit (letërnjoftim, pasaportë, kartë identiteti)
- Dokumentat (diplomë, librezë pune, vërtetim, dëshmi, vetdeklarim, certifikata, trajnime etj) fotokopje ose të noterizuar. Diplomata që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
- Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal (Vërtetim nga Gjykata, Vërtetim nga Prokuroria, Dëshmi e gjendjes gjyqësore)
- Vërtetim nga institucioni ku punon që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Një rekomandim nga punëdhënësi;
- Raport që vërteton se është në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme.

Kandidatët që plotësojnë kriteret formale dhe kanë depozituar dokumenta të fotokopjuara, përpara intervistës i prashtrajnë Komitetit ad-hoc dokumentat e njësuar ose ato origjinale.

## PENSIONET MANUALI I ISSH-së

Dokumentacioni që duhet dorëzuar për ata që marrin pension të parakohshëm

# ISSH publikon manualin, si llogaritet pensioni për burrat e gratë

## Ja cilat janë kushtet e përfitimit

Voltiza Duro

### ## PËRFITUESIT

Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka publikuar ditën e djeshme manualin mbi përfitimet që ofrohen nga sigurimet shoqërore. "Gazeta Shqiptare" publikon sot, tabelat që përcaktojnë daljen në pension për burrat e gratë, në bazë të moshës e vjetërsisë në punë. Të ardhurat që mund të përfitojë individit nga ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", janë: përfitimet nga pensionet, përfitimet nga dega e sigurimit të aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, përfitimet

nga dega e sigurimit të barërlindjeve si dhe përfitimet nga dega e sigurimit të sëmundjeve. Ndërkohë, nga dega e sigurimit të pensioneve, ISSH paguan përfitime

për të gjithë ata persona të siguruar që mund të marrin : pension pleqërie, pension të reduktuar pleqërie, pension si nënë me shumë fëmijë, pension invaliditeti, pension të reduktuar invaliditeti, pension të pjesshëm invaliditeti, pension familjar si dhe pagesë për vdekje.

për të gjithë ata persona të siguruar që mund të marrin: pension pleqërie, pension të reduktuar pleqërie, pension si nënë me shumë fëmijë, pension invaliditeti, pen-

sion të reduktuar invaliditeti, pension të pjesshëm invaliditeti, pension familjar, si dhe pagesë për vdekje. "GSH" publikon ditën e sotme kushtet që duhet të plotësojnë të interesuarit, dokumentacionin që iu nevojitet si dhe masën e përfitimit për pensionin e pleqërisë, pensionin e reduktuar të pleqërisë si dhe për pagesën që marrin nënat me shumë fëmijë.

#### PENSIONI I PLEQËRISË

Të gjithë qytetarët që plotësojnë moshën dhe periudhat e sigurimit sipas ligjit, kanë të drejtën e përfitimit të pensionit të pleqërisë. Gjithashtu, nënat që kanë lindur 6 a më shumë fëmijë, të cilët janë mbi 8 vjeç, kanë



të drejtë të dalin në pension kur mbushin moshën 55 vjeç dhe kanë 30 vjet periudhë sigurimi. Pensioni mujor i pleqërisë përbëhet nga një shumë bazë dhe nga një shtesë. Shuma bazë llogaritet si raporti i periudhës së sigurimit, që ka realizuar pensioni, me periudhën e sigurimit të kërkuar, sipas tabelave të daljes në pension pleqërie, bazuar në moshë dhe vite sigurimi, shumëzuar me pensionin social. Kjo shtesë do të jetë 1% për vit sigurimi shumëzuar me bazën mesatare të vlerësuar që personat e siguruar kanë arritur nëpërmjet kontributeve, por theksohet se shumica e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se pensioni social.

#### PENSIONI I REDUKTUAR I PLEQËRISË

Të gjithë ata individë që kanë periudha sigurimi, kanë të drejtë për pension pleqërie të reduktuar, deri tre vjet para mbushjes së moshës së daljes në pension. Gjithashtu nga kjo kategori pensioni përfitojnë ata persona që nuk kryejnë veprimtari ekonomike si të punësuar, punëdhënës, ose të

vetëpunësuar. Por, masa e pensionit të reduktuar të pleqërisë është pjesë e pensionit të pleqërisë e mbetet i reduktuar gjatë gjithë kohës së përfitimit. Ky pension llogaritet duke zbritur nga pensioni i pleqërisë shumëng që del nga shumëzimi i numrit të muajve të përfitimit të pensionit para mbushjes së moshës, me koeficientin mujor të reduktimit që është 0.6%. Në qoftë se një përfitues kërkon pension të reduktuar 20 muaj para mbushjes së moshës për pension të plotë pleqërie, nga pensioni i plotë mujor i llogaritur, që mund t'i caktohet 24.000 lekë, do t'i zbritet 12% (që del nga prodhimi i 20 (muaj) që e ka përfituar më shpejt pensionin e pleqërisë me 06%, që është koeficienti i miratuar).

#### PENSIONI PËR NËNAT ME SHUMË FËMIJË

Pensionin e plotë të pleqërisë e përfitojnë nënat mbi 55 vjeç që kanë lindur 6 ose më shumë fëmijë, që janë mbi 8 vjeç, të cilat kanë një periudhë sigurimi prej 30 vitesh e janë tërhequr nga veprimtari ekonomike. "Pensionin

Instituti i Sigurimeve Shoqërore

b) PËR GRATË

Vitet	Kategoria I		Kategoria II		Kategoria III	
	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës
1993	45	15	50	20	55	20
1994	45	15	50	21	55	21
1995	46	16	51	22	55	22
1996	46	17	51	23	55	23
1997	47	18	52	24	55	24
1998	47	19	52	25	55	25
1999	48	20	53	26	55	26
2000	48	21	53	28	55	28
2001	49	22	54	30	55	30
01.07.2002 - 30.06.2003	49	23	54	32	55v	32
01.07.2003 - 30.06.2004	50	24	55	34	56v	34
01.07.2004 - 30.06.2005	50	25	55v	35	56v	35
01.07.2005 - 30.06.2006	51	26	56v	35	57v	35
01.07.2006 - 30.06.2007	51	27	56v	35	57v	35
01.07.2007 - 30.06.2008	52	28	57v	35	58v	35
01.07.2008 - 30.06.2009	52	29	57v	35	58v	35
01.07.2009 - 30.06.2010	53	30	58v	35	59v	35
01.07.2010 - 30.06.2011	53	31	58v	35	59v	35
01.07.2011 - 30.06.2012	54	32	59v	35	60v	35
01.07.2012 - 30.06.2013	54	33	59v	35	60v	35
01.07.2013 - 30.06.2014	55	34	60v	35	60v	35
01.07.2014 - 31.12.2014	55v	35	60v	35	60v	35
01.01.2015 - 31.12.2015	56v	35	60v	35v	60v	35v
01.01.2016 - 31.12.2016	56v	35	60v	35v	60v	35v
01.01.2017 -	57v	35	60v	36v	60v	36v

Instituti i Sigurimeve Shoqërore

30.12.2017						
01.01.2018 - 30.06.2018	57v	35	60v	36v	60v	36v
01.01.2019 - 31.12.2019	58v	35	60v	36v	60v	36v
01.01.2020 - 31.12.2020	58v	35	61v	37v	61v	37v
01.01.2021 - 31.12.2021	59v	35	61v	37v	61v	37v
01.01.2022 - 31.12.2022	59v	35	61v	37v	61v	37v
01.01.2023 - 31.12.2023	60v	35	61v	38v	61v	38v
01.01.2024 - 31.12.2024	60v	35v	61v	38v	61v	38v
01.01.2025 - 31.12.2025	60v	36v	61v	38v	61v	38v
01.01.2026 - 31.12.2026	61v	36v	62v	39v	62v	39v
01.01.2027 - 31.12.2027	61v	37v	62v	39v	62v	39v
01.01.2028 - 31.12.2028	61v	37v	62v	39v	62v	39v
01.01.2029 - 31.12.2029	62v	38v	62v	40v	62v	40v
01.01.2030 - 31.12.2030	62v	38v	62v	40v	62v	40v
01.01.2031 - 31.12.2031	62v	39v	62v	40v	62v	40v
01.01.2032 - 31.12.2032	63v	40v	63v	40v	63v	40v
01.01.2033 - 31.12.2033	63v	40v	63v	40v	63v	40v
01.01.2034 - 31.12.2034	63v	40v	63v	40v	63v	40v
01.01.2035 - 31.12.2035	63v	40v	63v	40v	63v	40v
01.01.2036 - 31.12.2036	63v	40v	63v	40v	63v	40v
01.01.2037 - 31.12.2037	63v	40v	63v	40v	63v	40v
01.01.2038 - 31.12.2038	64v	40v	64v	40v	64v	40v
01.01.2039 - 31.12.2039	64v	40v	64v	40v	64v	40v

Instituti i Sigurimeve Shoqërore

01.01.2040 - 31.12.2040	64v	40v	64v	40v	64v	40v
01.01.2041 - 31.12.2041	64v	40v	64v	40v	64v	40v
01.01.2042 - 31.12.2042	64v	40v	64v	40v	64v	40v
01.01.2043 - 31.12.2043	64v	40v	64v	40v	64v	40v
01.01.2044 - 31.12.2044	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2045 - 31.12.2045	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2046 - 31.12.2046	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2047 - 31.12.2047	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2048 - 31.12.2048	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2049 - 31.12.2049	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2050 - 31.12.2050	66v	40v	66v	40v	66v	40v
01.01.2051 - 31.12.2051	66v	40v	66v	40v	66v	40v
01.01.2052 - 31.12.2052	66v	40v	66v	40v	66v	40v
01.01.2053 - 31.12.2053	66v	40v	66v	40v	66v	40v
01.01.2054 - 31.12.2054	66v	40v	66v	40v	66v	40v
01.01.2055 - 31.12.2055	66v	40v	66v	40v	66v	40v
01.01.2056 - 31.12.2056	67v	40v	67v	40v	67v	40v





← mujor i pleqërisë për-bëhet nga një shumë bazë dhe nga një shtesë. Shuma bazë llogaritet si raport i periudhës së sigurimit, që ka realizuar personi, me periudhën e sigurimit të kërkuar, 30 vite sigurimi, shumëzuar me pensionin social; - Shtesa do të jetë 1 për qind për vit sigurimi shumëzuar me bazën mesatare të vlerësuar që personat e siguruar kanë arritur nëpërmjet kontributeve, gjatë gjithë historisë kontributive; - Shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se pensioni social", citohet në manualin e ISSH-së.

**DOKUMENTACIONI**

Për të përfutur pension pleqërie, pension të reduk-

tuar dhe pension si nënë me shumë fëmijë përfituesi ose i autorizuari me prokurë paraqitet në Agjencinë Lokale të Sigurimeve Shoqërore (ALSSH) të vendbanimit, sipas regjistrimit në gjendje civile, për të bërë kërkesën e përfitimit të pensionit të pleqërisë. Përfituesi për pension pleqërie duhet të paraqesë dhe këto dokumente: Dokumentet që vërtetojnë moshën dhe identitetin; dokumentet që vërtetojnë periudhat e sigurimit dhe llojin e punës; si dhe dokumentet që vërtetojnë të ardhurat e realizuara. Ndërkaq, për personat që përfitojnë nga ligji nr. 7514, datë 30.09.1991 "Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënu-

**DOKUMENTACIONI PËR PENSION:**

**Dokumentet që vërtetojnë moshën dhe identitetin:**

- Fotokopje e kartës së identitetit;
- Certifikatë e gjendjes familjare;
- Certifikatë martesë (vetëm për kërkueset femra);
- Vërtetim nga Komuna/Bashkia për ndryshimin e gjeneralitetit;
- Vërtetim nga qendra e fundit e punës për gjeneralitetin.
- Dy fotografi.

**Dokumentet që vërtetojnë periudhat e sigurimit dhe llojin e punës:**

- Libreza e punës;
- Vërtetim për vjetërsinë në punë dhe llojin e saj;
- Vendimi i emërimit në punë, si kuadër në ish-kooperativat bujqësore;
- Vendim gjykatë për njohje të vjetërsisë në punë;
- Vërtetim i Degës Ushtrake për periudhën e kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak (për kërkuesit meshkuj);
- Vërtetim-tip i vjetërsisë në punë për ushtarakët;
- Fotokopje e noterizuar e diplomës së shkollës së lartë për kërkueset femra (kur kanë mbaruar studimet e larta, me shkëputje nga puna).

**Dokumentet që vërtetojnë të ardhurat e realizuara:**

- Vërtetim page, sipas së cilës është derdhur kontribut për periudhat e sigurimit që nga 01.01.1994 deri në momentin e shkëputjes nga puna, sipas formularit tip (nëse ka punuar dhe ka derdhur kontribute për periudhat pas datës 01.01.1994);
- Çdo dokument tjetër justifikues, që vërteton pagën ose derdhen e periudhave kontributive.

arve dhe të përndjekurve politikë" duhen edhe një vërtetim i gjendjes gjyqësore; vërtetim për kohën e vuajtjes së dënimit, vërtetim për faktin e dënimit për motive politike dhe kohën e vuajtjes

së tij, si dhe çdo dokument tjetër justifikues, që vërteton qenien në punë. Ndër dokumentet që vërtetojnë moshën dhe identitetin mund të përmendim fotokopjen e kartës së ident-

**Manastirliu: Skema e bonusit, 250 mijë lekë**

**Rritje me 5% për pagat e bluzave të bardha**



Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu

Pagat e mjekëve dhe infermierëve do të rriten deri në 5% duke filluar nga korriku i vitit 2018. Lajmi është bërë me dije nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu, e cila theksoi se do të pësojë rritje edhe skema e bonusit deri në 250 mijë lekë nga 100 mijë që është aktualisht, për të gjithë ata mjekë që do të punojnë në spitalet rajonale. "Do të ketë një rritje pagash duke filluar nga korriku i 2018-ës. Përfitues të rritjes deri prej 5% do të jenë rreth 18 000 mjekë dhe infermierë. Për motivimin e dërgimit të mjekëve në këtë zonë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nëpërmjet Ministrisë së Financave do të përdori skemën e bonuseve, duke rritur skemën e bonusit nga 100 mijë lekë ose 1 milionë lekë të vjetra në një rritje të konsiderueshme nga 200 mijë deri në 250 mijë lekë në muaj", u shpreh Manastirliu. Më tej ajo nënvizoi se përfituesit e ndihmës ekonomike, do të pësojnë dyfishim të pagesës e prej muajit janar të 2018-ës do të përzgjidhen me një skemë më të modernizuar. Në vitin e ardhshëm, buxheti i planifikuar për shëndetësinë do të arrijë vlerën 73 miliard e 80 milion lekë. Ministria bën me dije se do të bëhet një investim prej 260 milionë lekësh për përmirësimin e infrastrukturës në 80 qendra shëndetësore. Gjithashtu, do të vihen në ndihmë edhe 32 autoambulanca të reja.

itetit, certifikatën e gjendjes familjare, certifikatën e martesës, dy fotografi etj. Ndërsa, dokumentet që vërtetojnë periudhat e sigurimit dhe llojin e punës janë: libreza e punës; vërtetim për vjetërsinë në punë dhe llojin e saj; vendimi i emërimit në punë, si kuadër në ish-kooperativat bujqësore; vendim gjykatë për njohje të vjetërsisë në punë (nëse periudha e punës nuk provohet me dokumente zyrtare); vërtetim i Degës Ushtrake për periudhën e kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak; vërtetim-tip i vjetërsisë në punë për ushtarakët; si dhe një fotokopje e noterizuar e diplomës së shkollës së lartë për kërkueset femra.

a) PËR BURRAT						
Vitet	Kategoria I		Kategoria II		Kategoria III	
	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës
1993	50	20	55	25	60	25
1994	50	20	55	25	60	25
1995	51	21	56	26	60	26
1996	51	21	56	27	60	27
1997	52	22	57	28	60	28
1998	52	22	57	29	60	29
1999	53	23	58	30	60	30
2000	53	23	58	31	60	31
2001	54	24	59	32	60	32
01.07.2002 - 30.06.2003	54	24	59	33	60v 6m	33
01.07.2003 - 30.06.2004	55	25	60	34	61v	34
01.07.2004 - 30.06.2005	55	25	60v 6m	35	61v 6m	35
01.07.2005 - 30.06.2006	56	26	61v	35	62v	35
01.07.2006 - 30.06.2007	56	27	61v 6m	35	62v 6m	35
01.07.2007 - 30.06.2008	57	28	62v	35	63v	35
01.07.2008 - 30.06.2009	57	29	62v 6m	35	63v 6m	35
01.07.2009 - 30.06.2010	58	30	63v	35	64v	35
01.07.2010 - 30.06.2011	58	31	63v 6m	35	64v 6m	35
01.07.2011 - 30.06.2012	59	32	64v	35	65v	35
01.07.2012 - 30.06.2013	59	33	64v 6m	35	65v	35
01.07.2013 - 30.06.2014	60	34	65v	35	65v	35
01.07.2014 - 31.12.2014	60v 6m	35	65v	35v	65v	35
01.01.2015 - 31.12.2015	61v	35v 4m	65v	35v 4m	65v	35v 4m
01.01.2016 - 31.12.2016	61v 6m	35v 8m	65v	35v 8m	65v	35v 8m

Institut i Sigurimeve Shoqërore						
01.01.2017 - 31.12.2017	62v	36v	65v	36v	65v	36v
01.01.2018 - 31.12.2018	62v 6m	36v 4m	65v	36v 4m	65v	36v 4m
01.01.2019 - 31.12.2019	63v	36v 8m	65v	36v 8m	65v	36v 8m
01.01.2020 - 31.12.2020	63v 6m	37v	65v	37v	65v	37v
01.01.2021 - 31.12.2021	64v	37v 4m	65v	37v 4m	65v	37v 4m
01.01.2022 - 31.12.2022	64v 6m	37v 8m	65v	37v 8m	65v	37v 8m
01.01.2023 - 31.12.2023	65v	38v	65v	38v	65v	38v
01.01.2024 - 31.12.2024	65v	38v 4m	65v	38v 4m	65v	38v 4m
01.01.2025 - 31.12.2025	65v	38v 8m	65v	38v 8m	65v	38v 8m
01.01.2026 - 31.12.2026	65v	39v	65v	39v	65v	39v
01.01.2027 - 31.12.2027	65v	39v 4m	65v	39v 4m	65v	39v 4m
01.01.2028 - 31.12.2028	65v	39v 8m	65v	39v 8m	65v	39v 8m
01.01.2029 - 31.12.2029	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2030 - 31.12.2030	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2031 - 31.12.2031	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2032 - 31.12.2032	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2033 - 31.12.2033	65v 1m	40v	65v 1m	40v	65v 1m	40v
01.01.2034 - 31.12.2034	65v 2m	40v	65v 2m	40v	65v 2m	40v
01.01.2035 - 31.12.2035	65v 3m	40v	65v 3m	40v	65v 3m	40v
01.01.2036 - 31.12.2036	65v 4m	40v	65v 4m	40v	65v 4m	40v
01.01.2037 - 31.12.2037	65v 5m	40v	65v 5m	40v	65v 5m	40v
01.01.2038 - 31.12.2038	65v 6m	40v	65v 6m	40v	65v 6m	40v
01.01.2039 - 31.12.2039	65v 7m	40v	65v 7m	40v	65v 7m	40v

Institut i Sigurimeve Shoqërore						
01.01.2040 - 31.12.2040	65v 8m	40v	65v 8m	40v	65v 8m	40v
01.01.2041 - 31.12.2041	65v 9m	40v	65v 9m	40v	65v 9m	40v
01.01.2042 - 31.12.2042	65v 10m	40v	65v 10m	40v	65v 10m	40v
01.01.2043 - 31.12.2043	65v 11m	40v	65v 11m	40v	65v 11m	40v
01.01.2044 - 31.12.2044	66v	40v	66v	40v	66v	40v
01.01.2045 - 31.12.2045	66v 1m	40v	66v 1m	40v	66v 1m	40v
01.01.2046 - 31.12.2046	66v 2m	40v	66v 2m	40v	66v 2m	40v
01.01.2047 - 31.12.2047	66v 3m	40v	66v 3m	40v	66v 3m	40v
01.01.2048 - 31.12.2048	66v 4m	40v	66v 4m	40v	66v 4m	40v
01.01.2049 - 31.12.2049	66v 5m	40v	66v 5m	40v	66v 5m	40v
01.01.2050 - 31.12.2050	66v 6m	40v	66v 6m	40v	66v 6m	40v
01.01.2051 - 31.12.2051	66v 7m	40v	66v 7m	40v	66v 7m	40v
01.01.2052 - 31.12.2052	66v 8m	40v	66v 8m	40v	66v 8m	40v
01.01.2053 - 31.12.2053	66v 9m	40v	66v 9m	40v	66v 9m	40v
01.01.2054 - 31.12.2054	66v 10m	40v	66v 10m	40v	66v 10m	40v
01.01.2055 - 31.12.2055	66v 11m	40v	66v 11m	40v	66v 11m	40v
01.01.2056 - 31.12.2056	67v	40v	67v	40v	67v	40v



Table with columns: NR. DOSJES, EMER, MBEMER, VKM NR., EMER, ATESTA, MBEMER, DATEL INDIA, EMER, ATESTA, MBEMER, DATEL INDIA, KOPJE TE LETER NJOFTIM, NUMER PERSONAL LLOGAR, CERTIFIKATE VDEKJE, CERTIFIKATE TRINGU T FAMILJAR, DESHIMI TRASHIGIMIE, PROKURE. Includes names like ISLAM BIBA, HANE, REMZIE ASLAN, ZYLFI ASLAN, ZAMIRRA ASLAN, KIM ASLAN, SHEFIK ISLAM, ARJAN FLORIDA, SHEFIK BIBA.

Table with columns: NR. DOSJES, EMER, MBEMER, VKM NR., EMER, ATESTA, MBEMER, DATEL INDIA, EMER, ATESTA, MBEMER, DATEL INDIA, KOPJE TE LETER NJOFTIM, NUMER PERSONAL LLOGAR, CERTIFIKATE VDEKJE, CERTIFIKATE TRINGU T FAMILJAR, DESHIMI TRASHIGIMIE, PROKURE. Includes names like HIDA VESIRO, LIBI VESIRO, NIKOLLET A HIDA, GOZHINA, ORTITA HIDA, MIRBILA HIDA, VALENTINA LAZAR.

Table with columns: NR. DOSJES, EMER, MBEMER, VKM NR., EMER, ATESTA, MBEMER, DATEL INDIA, EMER, ATESTA, MBEMER, DATEL INDIA, KOPJE TE LETER NJOFTIM, NUMER PERSONAL LLOGAR, CERTIFIKATE VDEKJE, CERTIFIKATE TRINGU T FAMILJAR, DESHIMI TRASHIGIMIE, PROKURE. Includes names like PELO GOCI, TRICHIO RAO, MITRO PELO, STAVRO PELO, ILIJEVA SIBELKA, NATASHA, OLA NIKOLLA, VALENTINA NIKOLLA, ANKOLLA NIKOLLA, LIJAZAR NIKOLLA.

Table with columns: NR. DOSJES, EMER, MBEMER, VKM NR., EMER, ATESTA, MBEMER, DATEL INDIA, EMER, ATESTA, MBEMER, DATEL INDIA, KOPJE TE LETER NJOFTIM, NUMER PERSONAL LLOGAR, CERTIFIKATE VDEKJE, CERTIFIKATE TRINGU T FAMILJAR, DESHIMI TRASHIGIMIE, PROKURE. Includes names like PIREN LLESIAJ, MIRKE PIETER, GJIGJIBRE PIETER, ANGHELINA, DRANE PIETER, MARIANA PIETER, BARDHE NDUE, DORJAN NDUE, GJERGJ NDUE, PASHIRI AGJIM, DAVE NDUE, PRENE NDUE.

Table with columns: NR. DOSJES, EMER, MBEMER, VKM NR., EMER, ATESTA, MBEMER, DATEL INDIA, EMER, ATESTA, MBEMER, DATEL INDIA, KOPJE TE LETER NJOFTIM, NUMER PERSONAL LLOGAR, CERTIFIKATE VDEKJE, CERTIFIKATE TRINGU T FAMILJAR, DESHIMI TRASHIGIMIE, PROKURE. Includes names like TRIFON PRIFTI, VASIS PRIFTI, THEM PRIFTI, ARANIT TRIFON, PRIFTI, JULIETA TRIFON, VIKTOR, VIKTOR, PRIFTI GJOKAN.

Table with columns: NR. DOSJES, EMER, MBEMER, VKM NR., EMER, ATESTA, MBEMER, DATEL INDIA, EMER, ATESTA, MBEMER, DATEL INDIA, KOPJE TE LETER NJOFTIM, NUMER PERSONAL LLOGAR, CERTIFIKATE VDEKJE, CERTIFIKATE TRINGU T FAMILJAR, DESHIMI TRASHIGIMIE, PROKURE. Includes names like LEZE BRATHORI, PAL BRATHORI, DEDE, NDREKE DEDE, GJELAJ, AGJIM DEDE, VIOLLA DEDE, MIRUKA.

Table with columns: NR. DOSJES, EMER, MBEMER, VKM NR., EMER, ATESTA, MBEMER, DATEL INDIA, EMER, ATESTA, MBEMER, DATEL INDIA, KOPJE TE LETER NJOFTIM, NUMER PERSONAL LLOGAR, CERTIFIKATE VDEKJE, CERTIFIKATE TRINGU T FAMILJAR, DESHIMI TRASHIGIMIE, PROKURE. Includes names like SONOL ARUSHA, BEK, SONOL ARUSHA, BEK.

Table with columns: DOSJA NR., EMER, MBEMER, VKM NR., EMER, ATESTA, MBEMER, DATEL INDIA, EMER, ATESTA, MBEMER, DATEL INDIA, KOPJE TE LETER NJOFTIM, NUMER PERSONAL LLOGAR, CERTIFIKATE VDEKJE, CERTIFIKATE TRINGU T FAMILJAR, DESHIMI TRASHIGIMIE, PROKURE. Includes names like SABRI HOHA, HUSEN, MUJDE SALI, SHAGIR, HUSEN, NESIM, SELAM, NESIM, HODA, FARRI, NESIM, XHODUE, NESIM, HODO HOVA.

Table with columns: DOSJA NR., EMER, MBEMER, VKM NR., EMER, ATESTA, MBEMER, DATEL INDIA, EMER, ATESTA, MBEMER, DATEL INDIA, KOPJE TE LETER NJOFTIM, NUMER PERSONAL LLOGAR, CERTIFIKATE VDEKJE, CERTIFIKATE TRINGU T FAMILJAR, DESHIMI TRASHIGIMIE, PROKURE. Includes names like HIRAZI MIRAKAJ, BIRI, NIKOLA, PASHIK, ALIA, ZEF, PASHIK, MIRAKAJ, ARBIR, ZEF, ALIA.

Table with columns: DOSJA NR., EMER, MBEMER, VKM NR., EMER, ATESTA, MBEMER, DATEL INDIA, EMER, ATESTA, MBEMER, DATEL INDIA, KOPJE TE LETER NJOFTIM, NUMER PERSONAL LLOGAR, CERTIFIKATE VDEKJE, CERTIFIKATE TRINGU T FAMILJAR, DESHIMI TRASHIGIMIE, PROKURE. Includes names like ADEM MI (RUSTEMI), RUSTEM, RUSTEM, TAHIRI, SHAGIR, BAURAM, TAHIRI, QAZIM, BAURAM, TAHIRI, FADIL, BAURAM, TAHIRI, HAIRI, BAURAM, LUKATAHIRI, LAH, RUSTEM, HAKIM, RUSTEM, TAHIRI, ALI, HAIRI, TAHIRI.

Table with columns: DOSJA NR., EMER, MBEMER, VKM NR., EMER, ATESTA, MBEMER, DATEL INDIA, EMER, ATESTA, MBEMER, DATEL INDIA, KOPJE TE LETER NJOFTIM, NUMER PERSONAL LLOGAR, CERTIFIKATE VDEKJE, CERTIFIKATE TRINGU T FAMILJAR, DESHIMI TRASHIGIMIE, PROKURE. Includes names like ZEF, LKEGEGA, DOD, LKEGEGA, PIREN, DOD, LKEGEGA, GJIGJIBRE, DOD, LKEGEGA, GJELAJ, GJIGJIBRE, SHIELA, GJIGJIBRE, SHIELA, GJIGJIBRE, BARDHE, DOD, TUSHI, DILE, DOD, NUREU, NUREU, MARIKA, NUREU, VITORE, BEGRI, MARIJE, GIOJA, MARIJE, DOD, SYZU, ALEKSANDRA, NUREU, RUTE, DIDA, DIDE, NIJA, GJING, SYZU, PRION, SYZU, DOD, SYZU, LICE, SYZU, BARDHE, TOMA.

Table with columns: DOSJA NR., EMER, MBEMER, VKM NR., EMER, ATESTA, MBEMER, DATEL INDIA, EMER, ATESTA, MBEMER, DATEL INDIA, KOPJE TE LETER NJOFTIM, NUMER PERSONAL LLOGAR, CERTIFIKATE VDEKJE, CERTIFIKATE TRINGU T FAMILJAR, DESHIMI TRASHIGIMIE, PROKURE. Includes names like SADIK ULAJ, BARBAR, VACE, DELI, ULAJ, XHEMAL, BARBAR, ULAJ, HANE, XHEMAL, TRIESH, SMAJL, XHEMAL, ULAJ, GJEM, XHEMAL, ULAJ, HASJE, XHEMAL, CURPAJ, FADIL, XHEMAL, ULAJ, LIPRIE, XHEMAL, LUSJAJ, FUTUR, XHEMAL, LALUMOVIC, ISMET, XHEMAL, ULAJ, DAC, BARBAR, ULAJ, FARRI, DAC, ULAJ, XHEMAL, DAC, ULAJ, VERA, DAC, XHENDEBA, ORTE, DAC, HANRIJA, BUKURIE, DAC, NIKAJ, ARDIAN, DAC, ULAJ, YELI, DAC, ULAJ, XHEMADIN, DAC, ULAJ, SABAHET, DAC, YMERAJ, SELAMIN, DAC, ULAJ, DAN, BARBAR, ULAJ, MALIQ, BARBAR, ULAJ, SULTANE, BARBAR, ULAJ, KUTJIMTUR, ALI, LIKAJ, DUSHE, ALI, SELIMI, ASLAN, ALI, LIKAJ, RIZA, YMER, LIKAJ, SULEMAN, YMER, LIKAJ, TAZE, YMER, REKAJ, VERA, YMER, LIKAJ, YMER, KADRI, ULAJ, JONUZ, KADRI, ULAJ, XHEMAL, KADRI, ULAJ, ISAT, KADRI, ULAJ, ZADE, KADRI, ULAJ, SEMA, KADRI, LIKAJ.

Table with columns: DOSJA NR., EMER, MBEMER, VKM NR., EMER, ATESTA, MBEMER, DATEL INDIA, EMER, ATESTA, MBEMER, DATEL INDIA, KOPJE TE LETER NJOFTIM, NUMER PERSONAL LLOGAR, CERTIFIKATE VDEKJE, CERTIFIKATE TRINGU T FAMILJAR, DESHIMI TRASHIGIMIE, PROKURE. Includes names like LEZE, BRATHORI, PAL, BRATHORI, DEDE, NDREKE, DEDE, BRATHORI, GJELAJ, AGJIM, DEDE, BRATHORI, VIOLLA, DEDE, MIRUKA.

Table with columns: DOSJA NR., EMER, MBEMER, VKM NR., EMER, ATESTA, MBEMER, DATEL INDIA, EMER, ATESTA, MBEMER, DATEL INDIA, KOPJE TE LETER NJOFTIM, NUMER PERSONAL LLOGAR, CERTIFIKATE VDEKJE, CERTIFIKATE TRINGU T FAMILJAR, DESHIMI TRASHIGIMIE, PROKURE. Includes names like SONOL, ARUSHA, BEK.



# BLUE TOOTH

Thashetheme  
MADE IN ALBANIA

Nr. 584

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE

Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtune 11 Nentor 2017

## ALDON LIPE

### BEHET BABA PER HERE TE DYTE, VJEN NE JETE CHARLOT



**Historia e dashurisë me bashkëshorten që nisi në korridoret e RTSH.  
Pas djalit 13-vjeçar, moderatori babai i një vajze**

### HUEYDA EL SAIED

ndahet nga bashkëshorti,  
zbulohet arsyeja



### INTERVISTA

## ERISA XHIXHO:



### Ja si do të sillesha me "kundërshtarët" politikë në "C'est la vie"

Rrëfihet politikania: Edhe fushatës elektorale i thashë "STOP", për të shkuar pranë djalit. "Pasioni për muzikën dhe jeta e re me Henrin"

### BESI DHE XHENSILA

## GATI PËR T'U BËRË PRINDËR



## Hueyda El Saied ndahet nga bashkëshorti, zbulohet arsyeja

Prej kohësh ajo deklaronte se ishte lumturisht e dashuruar. Ndonëse është larguar nga jeta publike, Hueyda El Saied është ndër personazhet më të përfolura. Bëhet me dije se ditë e fundit, showgirli është ndarë nga bashkëshorti i saj. Arsyeja e ndarjes nga partneri është tradhtia që 55-vjeçari ka bërë. Edhe pse dukej se ajo ishte e lumtur me babanë e djalit të saj, francezin Michael Tamisier, i cili punon në Luksemburg në një kompani këshillimi financiar dhe investimesh, me të cilin kishte 5 vite njohje dhe 3 vitet e fundit bashkëjetonte, Hueyda i ka dhënë fund raportit me të. Mëson se ata kanë 6 muaj që janë ndarë dhe se shkaku i prishjes së marrëdhënies të tyre ishte tradhtia e partnerit të saj 55-vjeçar.



## Besi dhe Xhensila gati për t'u bërë prindër

*Ja deklarata e aktorit*

Dasma e tyre ishte një nga më të bujshmet në showbizin shqiptar. Gjithashtu, edhe muaji i mjaltit i Besit dhe Xhensilës ka qenë një nga më të përrallorët dhe tashmë mesa duket çifti është gati për të pasur fëmijën e parë. Ka qenë aktori i njohur Bes Kallaku, i cili gjatë emisionit "Wake Up" është shprehur se janë gati për të pasur një fëmijë. "Xhensila tani nuk ka më kënaqësi as për koncerte, as për muzikë. E ndjen dhe ma ka shprehur se është gati për familje", - theksoi Besi. Mesa duket së shpejti do të dëgjojmë lajmin e bukur se ata do të bëhen prindër për herë të parë.

## Bukuroshja nga Vietnami rrëmben kurorën e Miss Globe 2017

*Detajet e shfaqjes në Tiranë*

Pas një gare të gjatë me 55 bukuroshe nga e gjithë bota, përfaqësuesja e Vietnamit është shpallur Miss Globe 2017. Ceremonia e mbajtur mbrëmjen e së premtes së shkuar, në Parkun Olimpik në Tiranë, ka kurorëzuar me më të bukurën e globit bukuroshen e Vietnamit. Miss Globe 2017 njohu këtë vit pjesëmarrjen më të lartë të vajzave, të cilat përfaqësojnë vendet e tyre në këtë kompeticion bukurie të organizuar nga Deliant Association. Khánh Ngân është një studente ekonomie dhe turizmi, e cila objektivi të së ardhmes ka pikërisht këtë të fundit. Pjesëmarrja në Miss Globe dhe kurora e më të bukurës ka qëllim të përhapë në të gjithë botën bukuritë e Vietnamit, shkruan Class. Në Vietnam, bukuroshja është zgjedhur ambasadore e turizmit, ndaj edhe këtë çmim ajo ia dedikon vendit të lindjes, bukuritë e të cilit do t'i përcjellë anekënd globit. Kurorën e Miss-it Globe, Miss Vietnam e mori nga Miss Globe 2016, bukuroshja indiane Dimple Patel. Pak pas marrjes së çmimit, Ngân tha se vendi i saj prezantohet për herë të parë në Miss Globe dhe ajo është shumë e lumtur që është e para që e fiton kurorën në emër të vendit të saj. Surprizë e mbrëmjes ishte edhe prezantimi i spektaklit, i cili këtë vit iu besua Leonard Bombajt dhe bashkëshortes së tij, Esmeralda Blaceri.



## HISTORIA E DASHURISË ME BASHKËSHORTEN QË NISI NË KORRIDORET E RTSH

## ALDON LIPE


## bëhet baba për herë të dytë, vjen në jetë Charlot

*Pas djalit 13-vjeçar, moderatori babai i një vajze*

Të gjithë e njohin si zëri misterioz që na shoqëron çdo mëngjes në emisionin në TvKlan, "Aldo Morning Show". Ndërkohë që shumë pak mund të dihet për jetën e tij private, nga personazhi që fshihet misteriozisht pas mikrofonit të mëngjesit e që arrin të nxjerrë sekretet e shqiptarëve që telefonojnë. Aldon Lipe fshihet ngado për të mos e zbuluar fytyrën, por me zhvillimin e teknologjisë e aksesit të lehtë në internet, po e gjen të pamundur. Gati në çdo dalje njerëzit janë bërë të varur nga rrjetet sociale. Por "Bluetooth" i "Gazetës Shqiptare" ka arritur të zbulojë një lajm shumë të gëzueshëm për të. Pas 13 vitesh, ai është bërë baba për herë të dytë. Kësaj radhe i një vogëlusheje. Aldo prej vitesh është martuar me Ketiona Jubanin dhe janë prindër edhe të një tjetër fëmije, tashmë 13 vjeç, Marti. Tanimë, Marti do të ketë edhe një motër të vogël të quajtur Charlot. Fryti i dashurisë me Ketionën, i nisur që në televizionin shqiptar, ka sjellë edhe një tjetër gëzim pas kaq shumë kohësh në familjen Lipe.

Por përveçse të qenit personazh tepër i rezervuar në jetën e tij private, Aldo nuk kursehet të jetë vetvetja në emisionin e tij të mëngjesit (edhe pse i fshehur pas mikrofonit).

E veçanta e tij si personazh mëngjesi është se arrin të sjellë sadopak humor edhe mundësi për njohje të reja nëpërmjet telefonatave që bëjnë. Në programin e tij në TvKlan që nis çdo ditë në 6:55, mëngjeset e shqiptarëve janë bërë më argëtuese, pasi të gjithë po dëgjojnë nga radioja e makinës apo e autobusit se si dy njerëz të panjohur flasin për herë të parë tek Aldo Morning Show. Prezantuesi i njohur, që na zgjon prej disa viteve tashmë, është pas mikrofonit për të pritur gra e burra që për një arsye ose një tjetër, janë vetëm! Ajo që emisioni i tij arrin të bëjë s'është një mblesëri



nga ato që jemi mësuar të shohim, ato të rrënjësuar thellë në traditat tona. Përkundrazi. Aldo po thyen tabutë dhe frikën që vjen së bashku me divorcin në moshë të madhe, frikën se pas të 40-ave nuk ka më shpresë për të gjetur një partner me të cilin të kalosh jetën.

Aldo ka treguar në një intervistë pak kohë më parë se kjo ide ishte përpunuar më parë por kërkesat ishin shtuar: "Ideja e kësaj rubrike ka lin-



dur më parë, por së fundmi rastet e telefonatave të tilla ishin shtuar". Ndoshta rrjetet sociale kanë bërë që një pjesë e komplekseve të zhiduken dhe për ta të mos jetë

problem kërkimi i një partneri...edhe live në televizion, pse jo?

Telefonatat vijnë nga rrethet e ndryshme të vendit, pjesa dërrmuese nga Tirana dhe Durrësi, por jo domosdoshmërisht

tiranas apo durrsakë. Kërkesat janë pothuajse të njëjta: 'sinqeritet, besnikëri dhe të mos ketë vese'. Por, ka dhe pretendime të tipit që shkojnë deri në racizëm, sikur të mos jemi të gjithë shqiptarë.

Kjo është risia dhe e veçanta e programit të tij që e veçon nga të tjerët. Gjithsesi, edhe pse me pak "humor të zi" duke sjellë para dëgjuesve realitetin e hidhur shqiptar, ky program, sjell sadopak shpresë për njerëzit e vetmuar, sidomos të moshës së madhe të cilët edhe nuk kanë si ta shpëtojë kohën, dhe ku më mirë se sa të shprehësh hallet apo të gesh "shpirtin binjak" në Aldo Morning Show.



RRËFHEHET POLITIKANIA: EDHE FUSHATËS ELEKTORALE I THASHË "STOP", PËR TË SHKUAR PRANË DJALIT

# Erisa Xhixho:

## Ja si do të sillesha me "kundërshtarët" politikë në "C'est la vie"

Pamela Aliaj

Gjithnjë e kemi parë si pjesë të politikës duke qenë shpesh zëri i femrave të LRI dhe LSI pranë Monika Kryemadhit. Por kësaj radhe, ajo vjen në një paraqitje krejt të re për të gjithë ne. Politikania Erisa Xhixho këtë vit, përveç gjithë impenjimeve të shumta si pjesë e LSI apo edhe impenjimeve në punë e familje, është pjesë e show-t të njohur "C'est la Vie". E entuziazmuar, ajo flet në një intervistë për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare" për impresionet e natës së parë, prapaskanat me kolegët dhe simpatitë me të veçantat që ajo ka. Më tej Erisa na rrëfen impenjimet e saj të shumta mes punës dhe familjes, ku një ndër detajet që spikat është se si ajo ka lënë në mes fushatën elektorale për të qenë pjesë e ditëlindjes së vogëlushit Henri. "Nuk dua të humb asnjë moment të Henrit. Edhe në kulmin e fushatës që Henri kishte 1 vjetorin, unë i thash "Stop" për t'i dhënë atij vëmendjen që meritonte duke i organizuar një ditëlindje, siç e ëndërronim.", -ka thënë ajo.

Ju kemi parë vetëm në fushën e politikës, tanimë jeni edhe pjesë një show si "C'est la vie". Si e keni përjetuar natën e parë? Ishte një ftesë pjesëmarrja

apo një dëshirë e juaja?

Më propozuan organizatorët. E prita me qejf faktikisht, sepse mbaja mend kur ka qenë Monika para dhjetë vitesh në të njëjtin spektakël në edicionin e parë, në "C'est la vie". Ka qenë edhe dëshirë e imja, sepse kur kam qenë e vogël kam qenë pjesë e korit të shkollës, pjesë e "Sh-tëpisë se pionierëve". Adi Hila më thotë që kam vesh muzike (qesh), deri diku edhe zë dhe ka qenë ai që më inkurajoi dhe një mundësi që nuk të vjen shpesh. Adi Hila ishte ai që më propozoi për të qenë pjesë e show-t.

Partneri juaj në skenë ishte Erik Lloshi, si i keni marrëdhëniet me këngëtarin? E zgjodhët ju apo produksioni?

Ka qenë një përshtatje në zë edhe në karaktere me vokalet. Vendosëm bashkë-

isht që të ishte Eriku dhe besoj se jemi një çift në skenë shumë simpatik. Eriku është një këngëtar shumë profesionist me zë të veçantë dhe jam e kënaqur që bashkëpunoj me të.

Çfarë surprizash fsheh nata e dytë? Do të vazhdoni me të njëjtin partner?

Nata e dytë ka një surprizë shumë të bukur. Është një këngë romantike, në fakt, e preferuara ime, që e kam shumë për zemër, "Cosi celeste" të Zuchero. Është një nga këngët që është luajtur në dasmën time dhe ka një domethënie shumë të madhe për mua. / Do të vazhdoj me Erikun deri në fund të "C'est la vie", sepse partnerët janë të fiksuar për të gjithë deri në fund.

Përveç politikës për herë të parë po ju shohim teksa këndon. A është ky

*"Pasioni për muzikën dhe jeta e re me Henrin"*



një pasion i fshehur i juaji?

Përveç politikës, pasion tjetër imi janë udhëtimet, padyshim librat dhe studimet. Kjo ishte një nga arsyet pse iu ktheva si pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë, sepse të jep një mundësi të tillë të mos shkëputesh nga stu-

dimet.

Me kë ke marrëdhënie shumë të mirë në "C'est la Vie", përveç Erik Lloshit?

Më vjen shumë mirë që është zgjedhur si prezantuese Marina Vjollca. Ka kaluar çdo pritshmëri dhe është shumë e dashur me ne, një





vajzë vërtetë e veçantë, na lehtëson gjithë komunikimin. Nuk është diçka e lehtë, sepse është çdo gjë *live*, banda *live*, edhe këngëtarë profesionistë bëjnë gabime *live*, jo ne qe jemi dashamirës të muzikës.

**Kishe shoqëri më parë me ndonjë prej konkurrentëve?**

I njihja disa prej tyre, Ervin Bejlerin, Orin, Era Rusin, por jo dikë në veçanti dhe kjo është e bukura e këtij show që do krijojme miqësi të reja. Në fakt, pyeta para se të merrja pjesë se kush do të ishte pjesë e produksionit. Më erdhi mirë që çdonjëri prej tyre

**tikës është vetëm Erisa. Po të ishte një tjetër pjesëmarrës në show-n por "kundërshtar" politik që ke pasur "fërkime", do të merrje pjesë, si do të reagoje?**

Asgjë (qesh). Do ta mirëprisja, pasi në politikë ka kundërshtar në mendime, ide, por jo armiq .Besoj se kënga i sheshon të gjitha, sepse aty jemi më shumë për qejf. Është një programacion që përcjell energji pozitive të publiku, t'i kënaqi si ditë e diele. Ne kërcejmë aty dhe do të donim që edhe njerëzit nga shtëpia të kërcenin dhe ta shijonin, larg këtyre konflikteve dhe zhurmave të politikës. Kemi shumë

padyshim jurisprudenca zgjedhja ime. Kam investuar ne profesionin tim në Fakultetin e Drejtësisë, studimet master, doktorale edhe pse kam qenë e angazhuar politikisht padyshim që gjen kohë për çdo gjë. Pasi unë besoj se nëse je e aftë në një profesion mund të kontribuosh shumë mirë në politikë. Normalisht që nëse s'do të kisha politikën do isha më e fokusuar në jurisprudencë. Do të kisha studion legale timen, më e fokusuar në profesionin tim.

**Do të ishte këtu apo në Angli?**

Këtë nuk di ta them , por ka qenë një eksperiencë shumë


**të kujdesurit ndaj djalit? Pas bashkëshortit tuaj kush është ndihmesa juaj më e madhe për kujdesin ndaj djalit?**

Ardhja në jetë e Henrit ka ndryshuar të gjithë jetën e të dyve. Tani jemi familjarë me përgjegjësi, por dhe duke vazhduar pasionet dhe profesionat tona. Kemi angazhimet tona të dy, por kemi arritur t'i organizojmë shumë mirë. Përveç në të dyve është edhe

sishme ,është streha ku dashuria është pa kushte.

**Keni më tepër kohë tani për familjen?**

Sigurisht që kam më shumë kohë. Jam shumë e lumtur për këtë gjë. Nuk dua të humb asnjë moment të Henrit. Edhe në kulmin e fushatës që Henri kishte 1 vjetorin, unë i thashë "Stop" për t'i dhënë atij vëmendjen që meritonte duke i organizuar një ditëlindje siç e ëndërronim.



është profesionist në fushën e vet, qoftë në gazetari, akt- rim, biznes, etj. p.sh.: Eva Alikaj që unë e adhuroj dhe kam një simpati të veçantë për të. Të gjithë personazhet atje janë shumë të veçantë dhe japin një mesazh shumë të mirë për të gjithë publikun.

**D.m.th. nga fusha e poli-**

nevojë për një pozitivitet të tillë dhe jam shumë e lumtur që jam pjesë e një spektakli të tillë.

**Ju keni zgjedhur rrugën e politikës që në adoleshencë. Nëse s'do të ishte politika, çfarë të ardhme do të zgjidhni?**

Nëse nuk do të vazhdoja rrugën e politikës do të ishte

e bukur. Më ka dhënë një mënyrë tjetër të të menduari, të logjikuarit, të jetës atje. Kam shumë nostalgji dhe studimet atje kanë qenë investimi me i mirë për mua.

**Jeni tashmë prej një viti nënë e një vogëlushi të bukur, Henrit. Si i ndan oraret Erisa mes politikës dhe**

mami im dhe mami i Eneas që na ndihmon. I kemi afër të dyja dhe na ndihmojnë ato me mbajtjen e djalit. Gjithashtu, kemi edhe një dado që kujdeset për Henrin kur ne nuk jemi në shtëpi. Besoj se vitin tjetër do ta çoj në çerdhe.

**A keni në plan një motër ose vëlla për Henrin?**

Po padyshim që është dhe shumë shpejt, por mbetet në dorë të zotit kur do na bekojë me një engjëll tjetër.

**Jeni gati për netët pa gjumë?**

Po jemi gati, pasi familja për ne është gjeja më e rëndë-

Jam totalisht e përkushtuar ndaj Henrit, është në një fazë shumë të bukur tani se ka filluar të flasë të eci, të dhurojë përfaqime, puthje.

**Po ideja e emrit nga erdhi?**

Ka histori më vete emri. Bëmë një listë të gjatë të gjithë. Duhej një emër që të flitej shqiptohej mirë edhe shqip edhe në gjuhë të huaj, duke qenë se jemi një vend që po shkojmë drejt Europës. Ideja ishte më tepër e Eneas, e mbështetur fuqimisht nga unë. Emri Henri i ka marrë nur dhe djalit.

BOTIMI



Një nga shtabet britanike



Islam Radovicka, Spiro Moisiu, Enver Hoxha, britaniku Lik, Omer Nishani, Myslym Peza dhe Miladin Popović



Majori Oliver i shoqëruar nga partizanë

# Raporti anglez më '44: Enver Hoxha është kukull e emëruar

**L**ibri "Sekretet e luftës" - Shqipëria tjetër në dokumentet britanike i Erald Kaprit është rezultat i një pune 4-vjeçare të një shqyrtimi dhe leximi të dokumentacionit voluminoz në Arkivin Britanik, që u përket viteve 1943 dhe 1944, si dhe dokumente për fillimet e regjimit të Enver Hoxhës. Mbi 20 mijë faqe dokumente autentike janë lexuar dhe mes tyre janë përzgjedhur dokumente që hedhin dritë për disa nga çështjet më të nxehta të luftës, që nga bashkëpunimi me forcat pushtuese të një pjesë të elitës shqiptare, e deri tek lufta civile. Në këtë pjesë të librit që e boton 'GSH' jepen pjesë të raporteve të shkruara nga majorët J.F.P. Oliver dhe W.V. Smith për udhëheqjen shqiptare të kohës.

*Libri "Sekretet e luftës" i Erald Kaprit, "Spiro Moisiu është i trashë"*

*"Miladin Popović pa takt e acarues, Haxhi Lleshi ogurzi, Mehmet Shehu brutal"*



Në foto: Kopertina e librit

**Profillet e udhëheqësve komunistë dhe ushtarakëve partizanë në sytë e majorit Britanik J.F.P. Oliver.**

Majori britanik Oliver, në fund të vitit 1944, hartoi një raport të plotë për aktivitetin e tij ushtarak në Shqipëri që iu dorëzua Ministrisë së Jashtme Britanike. Oliver shprehet se mes aleatëve kishte dy teori në lidhje me mbijetesën e Hoxhës. Së pari, ata mendonin se Hoxha po nis një regjim të egër për të konsoliduar pushtetin e më pas t'u vinte kushte për ndihma aleatëve perëndimorë. Së dyti, ata mendonin se Hoxha kishte nisur tashmë një rrugë pothuaj vasaliteti, që kontrollohej nga jugosllavët dhe rusët. Sipas tyre, rruga e dytë ishte edhe më e lehta dhe kjo aspak për t'u surprizuar, nisur nga analiza që ata i bënin personalitetit të Enver Hoxhës, por edhe rolit që po fitonin misionet ruse dhe jugosllave në Tiranë. Majori britanik shprehet hapur më pas se anglezët dëshatuan në Shqipëri. Sipas tij, fakti që në Shqipëri u vendos një qeveri kundër tyre, e tregon mëse qartë. Nga ana tjetër, ai thotë se ata lanë në balte nacionalistët që luftuan kundër gjermanëve. Mbetet me mjaft interes përshkrimi i figurave qendrore komuniste në Shqipëri. Majori britanik J.F.P. Oliver flet për personalitetin e të gjithë atyre me të cilët punoi, duke nxjerrë në pah disa të thëna mjaft interesante në lidhje

me komunistët shqiptarë. Ai shprehet se Enver Hoxha nuk ishte popullor, por ishte më pompozi si dhe një person dhelpërak. Sipas tij, Mehmet Shehu u anashkalua nga qeveria komuniste pikërisht në postin që ai donte si ministër i Mbrojtjes. Po ashtu, edhe Oliver thekson se Shefi i Shtabit, Spiro Moisiu, ishte tërësisht i paafët.

**DOSJA: HS 5/ 134**

**(J.F.P. Oliver)** Pikëpamjet në lidhje me liderët partizanë që njoha:

Qeveria dhe Shtabi i Përgjithshëm **Enver Hoxha**: Komandant i përgjithshëm dhe President. Sillet i dashur dhe fryhet paksa. Është i keqinformuar. Jo ndonjë figurë popullore tek njerëzit, por më pompozi se çdokush tjetër në qeveri. Nuk të jep përshlypjen e një personi të fortë, por është dhelpërak dhe me siguri i paskrupull. Është i turpshëm në një shoqëri njerëzish që nuk janë të impresionuar nga ai dhe ka një pamje fizike sikur të

sugjeron që është i dashur dhe i butë.

**Nishani:** Ministër i Punëve të Jashtme. Fjalë të mira fliten për të. Thëkson në çdo takim se është anglofil dhe mund të gjykohej e vërtetë nisur nga sjelljet me ne. Shtaqi kritikua ndaj qeverisë gjatë pritjes që organizuan jugosllavët. Ka pikëpamje të moderuara nisur edhe nga qëndrimi jashtë vendit për një kohë të gjatë.

**Dishnica:** Ministër i Shëndetësisë. Një person me dije dhe idealist. Një komunist që vështirë të lejojë vendin e tij të dominohet nga të tjerët. Shtaqet me disa mosbesime ndaj nesh si në rastin kur në kryqin e kuq

etueshëm. Mbahet lart nga Hoxha dhe padyshim që ka edhe influencë. I përdorur si ambasador dhe nga pikëpamja e Hoxhës është jashtëzakonisht i përshtatshëm për atë që kërkon Enveri. Është anti-britanik.

**Konomi:** Ministër për drejtësi. Një komunist i zjarrtë, por i dobët dhe pa asnjë lloj përshlypjen nisur edhe nga mungesa e personalitetit. Sundohet nga antarët e tjerë të qeverisë.

**Çitaku:** Ministër i Financave. I raportuar nga ish-kreu i Bankës së Shqipërisë se nuk ia ka idenë aspak financave por si një komunist, pa asnjë dyshim pranoi detyrën nga kërkesa e dikujt tjetër. Ka adaptuar një sjellje të mirë ndaj nesh, por nisur nga sjellja e tij, duket sikur nuk i intereson vetvetja në politikën e vendit.

**Moisiu:** Shefi i Shtabit; aspak inteligjent dhe i ngathët. Ka shkaktuar me shumë vështirësi me

mungesën e tij të bashkëpunimit se kushdo tjetër në grup. Ndoshta është vendosur qëllimisht nga Hoxha aty ku është, por Moisiu s'ka asnjë aftësi për të bërë më shumë seç i thonë. Fakti që Hoxha e mban larg ndaj çdo lloj marrëveshjeje të madhe, kjo është për shkak se është i trashë, jo për ndonjë arsye tjetër.

**B) LIDERËT USHTARAKË**

**Ndreu:** Gjatë Ndreut: Gjatë gjithë kohës, një person i arsyeshëm dhe me një temperament të qetë. Unë besoj se ai i vetëm mes komandantëve të tjerë mori detyrën për të mundur gjermanët para se regjimi i ri të vendosej. Gjithsesi, një shërbëtor besnik e i

zgjuar i Hoxhës. Ai ka qenë i lirë në bashkëpunimin e tij me ne dhe do të ishte 100%.

**Shehu:** Arrogant dhe brutal (kjo nga ambicia dhe kompleks i inferioritetit që ka). Dikush më thotë se Shehu është njeri i pakënaqur dhe se qeveria duke e ditur dëshirën e tij të pamasë të rrijë pranë ushtrisë, e sistemoi në pozicionin aktual (ndoshta donte Ministrin e Mbrojtjes). Tashmë larg nga kontaktet direkte me njerëzit, ai do të zhytet në background dhe do të ketë shumë pak shanse për t'u bërë lider në rangun që ai dëshiron. Komandant me vlerë në terren, i ashpër dhe me prestigj, që e fitoi edhe nga posterat gjermane.

**Kapo:** Një diplomat inteligjent me disa skrupuj. Të jep përshlypjen se ka më shumë pushtet se grada e tij e kolonelit. Ai padyshim ushtron një influencë më të madhe se ajo e Dalit Ndreut dhe është mbi komisarët e tjerë, me përjashtim të Koçi Xoxës.

**II- MAJORI W. V. SMITH Vlerësimet e numrit 2 të misionit britanik, Majorit W.V. Smith për personazhet kryesorë.**

Majori Smith ishte numri dy i misionit britanik gjatë luftës në Shqipëri, hartoi një raport të hollësishtëm për zyrën e luftës së Britanisë së Madhe më qershor 1944 mbi aktivitetin e tij të plotë prej 8 muajsh në Shqipëri. Raporti i tij merr vlerë nga ky fakt për shkak të qëndrimit të tij afër komunistëve shqiptarë. Qendra i kërkoi atij një raport në lidhje me aktivitetin, ç'ka Smith e dorëzoi në qershor të vitit 1944. Ky raport erdhi pas përplasjes së parë me britanikëve dhe komunistëve në Shqipëri, për shkak se oficerë britanikë shkuan pranë Abaz Kupit. Ky raport tregon këtë përplasje të parë. Ai përshkruan figurat politike dhe ushtarake të LNÇ dhe jep një panoramë krejt interesante për personalitetin e Enver Hoxhës, Spiro Moisiut, Mehmet Shehut etj.

**Dosja: HS 5/129**  
**Raport nga Major Smith për periudhën 15 tetor 1943- 16 qershor 1944**

Në kapacitetin tim si numri dy i misioni pas Lt. Col Palmer, unë kam pasur të bëj kryesisht me komandantët ushtarakë. →



Në foto: Harta e ndarjes së Shqipërisë me nacionalistëve dhe partizanëve

shqiptar nuk tregoi për burimin e furnizimeve dhe po ashtu edhe në disa çështje të tjera me njerëz të partisë.

**Spahiu:** Ministri për Rindërtim. Një komunist i zjarrtë i paarsy-





Opinion **i** Ditës

Nga Julian Zyla

(Vijon nga faqja e parë)

... burime në zbardhjen e rasteve të rrjedhjes së informacioneve te gazetaret. Gjithashtu, gazetaret nuk shihnin me sy të mirë komunikimin e drejtpërdrejtë të tij me publikun në mediat sociale apo nëpërmjet emisioneve argëtuese. Këto ishin disa nga pakënaqësitë e gazetarëve ndaj tij, të cilët ndiheshin të shmangur. Megjithatë, ata nuk mund ta citonin z. Obama aq lehtë sa mund të citojnë Presidentin aktual Trump në deklaratat e tij kundër mediave. Z. Trump quan CNN "fake news", një kategori kjo, e lajmeve të rreme, ku ai fut shumicën e mediave tradicionale dhe dixhitale.

Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama është në një situatë më të ngjashme me atë të z. Trump, pas deklaratave të tij të fundit dhe duke pasur parasysh faktin që askush nuk diskuton më të drejtën e udhëheqësve për të komunikuar drejtpërdrejt apo në mënyrë argëtuese. Pra, me deklaratat e tij kryeministri Rama ka tashmë një "skandal" të ri. A e donte një gjë të tillë? A ishte një ide e mirë krijimi i tij apo pakujdesia për ta shmangur apo përmbytur?

Ajo që gjatë këtij artikulli do ta quaj Çështja "Mediat" ka dy mundësi. Mundësia e parë është që kryeministri është i sinjertë në pakënaqësitë e tij ndaj gazetarëve. Nëse kjo është e vërteta, ai mund të shprehej/t ndaj tyre në mënyrë pozitive: "Unë e di që puna juaj nuk është e lehtë me gjithë vështirësitë që

# Çështja "Mediat"



keni, por si kryeministër i vendit do ju ftoja të bëni më shumë kujdes për të pasur një nivel më të lartë përgjegjësie në përzgjedhjen e informacioneve dhe fjalëve që përcillni gjatë punës suaj. Më konkretisht, ..." Kjo qasje do të mund të kontribuonte në zgjidhjen e problemit, pa krijuar një problem tjetër.

Mundësia apo skenari i dytë është që çështja "Mediat" të jetë prodhuar me dashje. Në këtë rast, do të kishim të bënim me një përlogaritje politike të nxituar. Është e vërtetë që me pozitivitet nuk do të kishim pasur debat dhe pa debat nuk do të mund të ishte larguar vëmendja nga debati mbi çështjen pararendëse. Por është, gjithashtu, e vërtetë që potenciali dëmtesues i çështjes

"Mediat" nuk është aspak më i vogël politikisht për z. Rama. Kjo sjellje rrezikon ta rendisë atë përkrah rastesh të tjera të udhëheqësve autokratikë, gjë për të cilën votuesit e liderit modern Edi Rama, nuk do ishin të lumtur.

Ngjashmëria e strategjisë së kryeministrit Rama me atë të Trump ka një problem. Trump vepron në një kontekst ku publiku i tij, republikanët, besojnë vërtet se mediat janë tepër liberale dhe të majta, dhe si rrjedhojë mund të jenë të padrejta me presidentin republikan. Në Shqipëri, nuk ka ndonjë opinion mbizotërues se mediat janë me PD.

Gjithashtu, është e vërtetë që dominimi i çështjes "Mediat" ka qenë total. Por kjo është

të një çështje që nuk ekzistonte më parë dhe mbetet e saj mund të jenë rezistente ndaj kohës. Mbi të gjitha, ajo vetëm përkohësisht mund të largojë vëmendjen nga çështje të tjera. Ato mund të rikthehen në momentin e parë që ka një lajm lidhur me to. Ashtu si ndodhi me lajmin Sota.

Një strategji tjetër që mund të ketë lënë të paqartë edhe mbështetësit e kryeministrit ishte heshtja ndaj atij lajmi. Teorikisht, ajo heshtje mund të ishte e këshillueshme. Por jo pas deklaratave të bëra rregullisht gjatë ngjarjeve të mëparshme. Pra, ishte një heshtje që ushtoi shumë.

A mund t'i lejohet kryeministrit të shprehë ose të mos shprehë opinionin e tij? Natyrisht që po. Por mënyrat se si këto opinione shpalosen kanë rëndësi. Nëse veshja ndikon në krijimin e një identiteti, mund të imagjinohet lehtë ndikimi që mund të kenë llojet e komunikimit. Gjatë punës së tyre mund të gabojnë si gazetaret ashtu edhe politikanët. Por kur gabimi mund të jetë strategjia e një jave të plotë, efekti që mund të shkaktohet mund të gdhendet në identitet më fort sesa imazhi i një veshjeje.

Barak Obama kujdesej mjaft, si për veshjen ashtu edhe për komunikimin. I renditur menjëherë si presidenti i 12-të më i mirë amerikan, ai vlerësohej mes të tjerash për aftësitë e tij të komunikimit. Për veshjen kishte një rregull të thjeshtë: "Do të më shihni duke veshur vetëm kostume blu ose gri (të zënë). Përpigjet të pakësoj vendimet. Nuk dua të marr vendime për çfarë do të ha apo do të vesh. Kam shumë vendime të tjera për të marrë". Këtë rrëfim ai e bëri gjatë një interviste si President i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për revistën "Vanity Fair", një nga mediat amerikane, për të cilat zakonisht shprehej me respekt.

## Republika Çeke, 900,000 dollarë ndihmë për mbrojtjen e Ballkanit Perëndimor nga ndryshimet klimatike

*Përfshihen Shqipëria, Maqedonia, Serbia, Mali i zi, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia*

Nga Mira Bregu


**P**ërmbytjet ekstreme i kushuan Ballkanit Perëndimor 86 jetë dhe 3.5 miliardë dollarë dëmshpërblime në 2014.

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin njoftoi sot se Republika Çeke do investojë 20,000,000 Koruna çeke, rreth 900,000 dollarë për të ndihmuar Serbinë dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, që bëhen gati për të përfutur nga Fondi i Klimës së Gjelbër.

Fondi pritet të bëhet një burim i financimit global për ndryshimet klimatike, zbutjen dhe përshtatjen në vitet e ardhme. Ai mbështet projektet të ndryshme nga këto vende të energjisë së ripërtëritshme në sistemet e informacionit klimatik dhe bujqësinë e qëndrueshme ndaj klimës.

Vendet e Ballkanit Perëndimor tashmë mund të hyjnë në Fond, por do të kërkojnë mbështetje teknike për të zhvilluar propozime në përputhje me kriteret e investimit të Fondit. Mbështetja e OKB-së do të sigurojë asistencën e nevojshme teknike, duke ofruar gjithashtu një platformë për konsultime me shumë palë të interesuara, ku do të sigurojnë që propozimet të pasqyrojnë si prioritetet kombëtare të adaptimit të ndryshimeve klimatike, ashtu edhe ato rajonale.

Investimet e Republikës Çeke do të ndihmojnë për të siguruar që Ballkanit Perëndimor të mund të aspirojë në një të ardhme të ulët të karbonit dhe të rrisë elasticitetin



tin ndaj ndryshimeve klimatike, që tashmë kanë një efekt shkatërrues në rajon.

Përpara edicionit të këtij viti të negociatave ndërkombëtare për klimën, në Pragë u nënshkrua një marrëveshje e donatorëve më 24 tetor nga zministria e Mjedisit, znj. Berenika Peštová dhe Z. Jan Dusik, drejtor i BE-së për mjedisin në Evropë.

### PIKAT KYÇE KLIMATIKE NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Vendet e Ballkanit Perëndimor tashmë janë përballur me përmbytje të mëdha të lidhura me ndryshimet klimatike. Në vitin 2014, përmbytja ekstreme kushtoi të paktën 86 jetë dhe 3.5 miliardë dollarë në dëmtime, ndërkaq janë shkatëruar rreth 2,000 rrëshqitje të tokës në të gjithë rajonin.

Rajoni tani parashikohet të përballë me rritje të temperaturave të ajrit në një normë më të lartë se mesatarja globale në dekadat e ardhshme. Kjo ka të ngjarë të çojë në zjarret më të rënda dhe të shpeshta të pyjeve dhe thatësirës, e cila në vitin 2012 uli rendimentet në disa kultura të caktuara përgjysmë, duke shkatëruar humbje prej rreth dy miliardë dollarë vetëm në Serbi.

Raporti i OKB-së mbi Adaptimin e Klimës për Ballkanin Perëndimor i vitit 2015, gjithashtu tregon për gjasat e rritjes së vdekJeve që lidhen me stresin e nxehtësisë dhe fijeve të reja të sëmundjeve dhe llojeve të dëmtesues, që dalin për shkak të ndryshimit të klimës në rajon.

Projekti, me qëllim lehtësimin e qasjes në Fondin e Klimës së Gjel-

bër, do të zbatohet nga Zyra e OKB-së për Mjedisin në Vjenë, duke filluar nga dhjetori 2017 dhe do të zgjasë dy vjet. Ajo do të ndihmojë vendet e Ballkanit Perëndimor në përkthimin e vullnetit të fortë politik për trajtimin e ndryshimeve klimatike në veprime konkrete, që i përgjigjen këtij kërcënimi global.

Shqipëria, Mali i Zi dhe Serbia kanë paraqitur tashmë propozime në kuadrin e Programit të Gatishmërisë dhe Përgatitjes së Fondit të Klimës së Gjelbër dhe aktivitetet shtesë të financuara nga Republika Çeke do të rritin punën përgatitore, duke përfshirë përgatitjen e propozimeve dhe përpjekjet për ndërtimin e kapaciteteve.

OKB-ja tani do të kërkojë ndihmë teknike nga një partner implementues për të kryer projektin. Partneri do të jetë udhëheqës i një

institucioni shkencor, që e njeht rajonin dhe ka përvojë të konsiderueshme në politikën klimatike dhe financat.

Investimi nuk është i pari i bërë nga Republika Çeke për sigurimin e rajonit nga rreziqet që lidhen me klimën. Në vitin 2014, Praga investoi 45,000 dollarë për të ndihmuar Bosnjën si faktor global i angazhimeve mjedisore brenda rregullave të saj kombëtare dhe vendimarrje. Gjithashtu, ajo mbështeti sektorin hidrologjik të vendit, në mënyrë që të dhënat për rreziqet e fatkeqësive natyrore të mund të mblidheshin dhe të ndaheshin me qytetarët.

### SFOND

Fondi i Klimës së Gjelbër, i themeluar në vitin 2010, është mekanizmi financiar i Konventës së Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike dhe Marrëveshjes së Parisit. Ai u krijua për të adresuar zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe nevojat e adaptimit të vendeve në zhvillim.

Emri i plotë i projektit të ri të OKB-së mbi mjedisin është "Programi për lehtësimin e angazhimit dhe qasjes në Fondin e Klimës së Gjelbër për Serbinë dhe/ose vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor".

Mjedisit i OKB-së ka përvojë të konsiderueshme në ndihmën e vendeve për t'iu përgjigjur sfida të lidhura me ndryshimet klimatike, duke ndihmuar 15 vende të plotësonin planet kombëtare të adaptimit të klimës dhe ndihmuar 38 vende të zhvillojnë komunikimet kombëtare me Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike.

U-21



21-vjeçarët kuqezinj ishin vetëm pak minuta larg fitores, por Irlanda e Veriut ka arritur të barazojë gjithçka, për të marrë një pikë dhe kreun e grupit të dytë pas 5 ndeshjesh, teksa është ngjitur në kuotën e 10 pikëve. Kuqezinjët e Alban Bushit kanë qenë superiorë në fushën e lojës, duke e mbajtur kundërshtarin në mesfushën e tij, por rastet e mira për shënim do të jenë me

## Shqipëria e pafat, frenohet nga Irlanda e Veriut

pikatore, ndërsa në 45 minutat e para nuk do të krijohet asnjë mundësi realizimi. Në pjesën e dytë, 21-vjeçarët shqiptarë janë më kërkuar, ndërsa në minutën e 60-të Zeka do të provojë nga jashtë zonës, por topi do të dalë ngjitur me shtyllën e port-

ierit Mitçell. Sërish Zeka do të provojë në të 73'-ën, por edhe njëherë është i vëmendshëm gardiani irlandez-orientor. Gjithsesi, Shqipëria do ta konkretizojë epërsinë e saj në minutën e 83-të, kur Ylber Ramadani nga jashtë zonës do ta çojë

topin në këndin e largët të Mitçellit. Shpërthen festa te kuqezinjët, festë që i bën të harrojnë mbrojtjes, pasi në minutën e 89-të, Levi përfiton nga vendosja e keqe e mbrojtësve dhe me kokë thyen Selmanin, duke vultosur barazimin. Shqipëria me këtë barazim ngjitet në kuotën e 6 pikëve, ndërsa në 5 takime të luajtura, ka mundur të fitojë vetëm ndaj Islandës.

Lojtarët më të rinj që janë afruar në Kombëtare janë të paduruar të japin kontributin e tyre

# Ajdareviç e Qaka ëndërrojnë debutimin

Mesfushorët janë të lumtur me ambientin e gjetur



Jeton Selimi

Shqipëria do të luajë me Turqinë dhe në listën e Panuçit janë dy risi, të cilët po presin me padurim të japin kontributin e tyre për fanellën e kuqe. Si Astrit Ajdareviç, ashtu edhe Kamer Qaka, do të ishin të kënaqur edhe me pak minuta, boll që të realizonin ëndrrën e tyre. Ajdareviç ka qenë kapiteni i përfaqësueses së moshave të Suedisë, por thekson se ëndrra e tij ka qenë fanella e Shqipërisë. "Të gjithë më kanë pritur mirë. Kam pritur shumë vjet për këtë grumbullim. Edhe për mua dhe për familjen time, jam i kënaqur që jam këtu. Do jap gjithçka. Ishte kënaqësi, pasi e prisja prej shumë kohësh dhe kam luajtur për Suedinë. E kam pasur të vështirë, pasi jam rritur atje, por gjithmonë do e them se jam shqiptar. Shumë e lehtë të përshattem me grupin. Edhe këtu, edhe në klube ka



konkurrencë. Kam 15 vite si profesionist. Shpresoj të luaj disa minuta dhe të tregoj kualitetin tim. Ekipi është i fortë dhe ka shumë talente. Edhe në Europian e tregoi vlerën që ka. Pozicioni im

është mesfushor sulmues, si një numër '10', por mund të përshattem edhe në pozicione të tjera. Jo shumë njerëz më njihnin dhe janë skeptikë prej mbiemrit. Ne e kemi mbiemrin Hajdari, por

prej shkak të luftës e kemi ndërruar, por ne jemi shqiptarë". Kamer Qaka nuk i ka mbajtur lotët e gëzimit kur ka marrë ftesën e grumbullimit, ndërsa tani kërkon që të festojë fitoren me Tur-

qinë, ndërsa shprehet i kënaqur me ambientin që ka gjetur në Kombëtare. "Kur më morën në telefon, nisa menjëherë të qaj. Që kur kam qenë i vogël, e kam parë Kombëtaren të luajë dhe ka qenë një ëndërr për mua të jem pjesë e saj. Çunat janë shumë të mirë, luftojnë në lojë. Unë dhe familja ime kemi pasur qejf që të luaj për vendin tim. Kur mora ftesën, nuk e mbajta dot veten. Tani po e shoh edhe vetë sa ekip i mirë është Shqipëria. Ka shumë talente. Unë jam nga Peja e Kosovës dhe tashmë Shqipëria më ka plotësuar ëndrrën. Një minutë, apo dy edhe tri, nuk ka rëndësi sa aktivizohem, rëndësi ka që të fitojë ekipi. Jam krenar që jam këtu".

VLON PAAFËTËSI NË FEDERATË



FSHF-ja bën lëmsh kalendarin, Flamurtari-Skënderbeu luhet të enjten

Federata Shqiptare e Futbollit njoftoi para disa ditësh për kalendarin e 3 javëve të ardhshme të Kategorisë Superiore, duke përcaktuar datat dhe orët kur do të zhvilloheshin takimet. Por, ditën e djeshme institucioni më i lartë i futbollit ka ndryshuar sërish mendje, duke fshehur lajmërimin e mëparshëm dhe duke bërë një spostim të ndeshjeve. Sfida Flamurtari-Skënderbeu, që ishte përcaktuar të zhvillohej ditën e mërkurë, do të luhet të enjten në orën 17:00. Ndryshime ka pasur edhe në ndeshjet e javës së 11-të, ku Luftëtari-Laçi dhe Kukësi-Partizani do të luhet të hënën e 20 nëntorit në orën 14:00, ndërsa Lushnja-Flamurtari, Teuta-Vllaznia dhe Skënderbeu-Kamza do të zhvillohen ditën e diel.

## PATRICE EVRA

### UEFA e pezullon 8 muaj, Marseja i prish kontratën



Një shkëlqim në fytyrën e një tifozit duket si i ka kushtuar shtrenjtë mbrojtësit francez të Marsejës, Patrice Evra. Incidenti i ndodhur në Portugalin, në prag të sfidës mes Guimaresit dhe Marsejës, ku Evra goditi me shkëlqim në fytyrë një tifoz francez, u mor në shqyrtim nga institucioni më i lartë i futbollit evropian. UEFA ka vendosur një pezullim të gjatë për ish-mbrojtësin e Juventusit dhe Manchester Junajdit, prej plot 8 muajsh, ose deri në qershor të 2018-ës, kohë kur përfundon edhe sezoni aktual i futbollit. Më herët, Evra u pezullua pa afat edhe nga klubi i Marsejës, që tani njoftoi edhe prishjen konsensuale të kontratës me mbrojtësin.

## ARGJENTINA

### Sampaoli "ndez" shpresat e Higuainit për të marrë pjesë në Botëror


Gonzalo Higuain është rikthyer në formë dhe të shënjojë gola me Juventusin, por sërish i mungon thirrja në Kombëtaren argentinase. Trajneri i Argentinës, Jorge Sampaoli e ka lënë jashtë sulmuesin e bardhezinjve, me arsyetimin se nuk i duhet një sulmues me ato karakteristika, për skemat e tij. Në vend të Higuainit është preferuar kapiteni i Interit, Mauro Icardi, që gjithsesi nuk ka luajtur gjithmonë titullar. Pasditën e sotme, në një konferencë për shtyp para miqësorës me Rusinë, trajneri i Argentinës i ka dhënë shpresë Higuainit për t'u grumbulluar në Botëror. "Ne i dimë mirë vlerat e Higuainit dhe e kemi tërë kohë në konsideratë. Nuk është grumbulluar për arsye që i kam thënë edhe herë të tjera, por kjo nuk do të thotë që dyert e kombëtares janë të mbyllura për të. Po studiojmë futbollistët të shumtë dhe Higuain mund të jetë njëri prej tyre, që do të përfaqësojë Argjentinën në 'Rusi 2018', tha Sampaoli.



## VLERËSIMI

### Mediat italiane: Strakosha, një nga zbulimet më të mira të sezonit

Në një analizë që "Gazzetta dello Sport" bën për Lacion e këtij sezoni në Itali, ndër të tjera, vë në dukje edhe portierin shqiptar Strakosha, duke e cilësuar si një nga zbulimet më të mira të sezonit. Gjithçka fillon nga tekniku Simone Inzaghi, i cili erdhi si një "gomë rezervë", pas shkarkimit të Bielsës nga presidenti Lotito. Ai është arkitekti i kësaj skuadre që po i surprizon për mirë të gjithë në Itali. Rezultatet që ka arritur janë fantastike. Me një fitore ndeshje e fundit, e cila u shtoi prej shiut, ndaj Udinezes, ekipi lacial do ngjitet në vendin e dytë në renditje. Më pas, sigurisht vlejnë pa masë golat e Çiro Imobiles. 14 gola në kampionat dhe dy në Europa Ligë. Golashënuesi më i mirë për momentin në Seria A. Mes lojtarëve surprizë identifikohen Kaisedo, Luis Alberto dhe sigurisht, Tomas Strakosha, i cili cilësohet edhe si një nga zbulimet më të mira të sezonit. Nota mesatare për shqiptarin është 6.55, notë e lartë për një portier.



## INTERVISTA

# Gjuha e Ramës me mediat, Krasta: S'dua të komentoj figurat në rënie

"Marrëdhëniet me kryeministrin i kam siç i kam pasur tërë jetën"

Eni Vasili

Adi Krasta ka bërë mbrëmë disa deklarata të forta si rrallë herë. I ftuar në emisionin "Studio e hapur" të Eni Vasilit në "News 24", Krasta kë dhënë opinionin e tij mbi çështjet më të nxehta në vend, siç pak herë ka bërë. Kanabisi, kazani mediatik, kryeministri i vendit, çështja Tahiri e jo vetëm kanë qenë në qendër të vëmendjes. Ai po ashtu ka treguar se do jetë i angazhuar me festivalin e fundvitit në RTSH dhe se marrëdhëniet e tij me kryeministrin janë siç i ka pasur gjithë jetën. Ai tha se tashmë është konfirmuar nga të gjitha burimet e mundshme, se territori i vendit është kanabizuar me qëllim. Ikona e medias në një intervistë për lirinë, gazetarinë, qeverinë dhe shpresën,

**- Gati dy muaj larg kanzit mediatik, kështu na quan kryeministri, ndjehesh ndopak kaskan dhe çfarë mendon?**

Zakonisht në bisedat televizive dhe njerëzore në tavolina të ndryshme është e lehtë të mbërrish në atë momentin kur diskuton për njerëz të rëndësishëm, siç është edhe kryeministri. Unë kam ardhur me qejf në studion tënde, nuk do kisha dashur që intervista e sotme të ishte në kërkim të atyre titujve të lidhet me një gjykim për kryeministrin që s'është qëllimi im dhe fusha e ekspertizës. Kam një moto të brendshme që nuk diskuton figura në rënie, pasi kjo është gjithmonë jo e shëndetshme

**- Është kryeministri në rënie?**

Krasta: Në këtë vend është e vështirë të rrih në këmbë, ka qenë Noli i palumtur, Konica ka nxjerrë përcaktime të tmerrshme për këtë vend. Duhet të jesh shumë i kulturuar, i devotshëm dhe i ndershëm që të sigurosh mos rënie e pashmangshme në këtë vend

**- Pse po bie Rama?**

Stigmatizimit janë shenja e të dobët, shoh shenja të rrëshqitjes, të pasigurisë

**- E ndoqe në komunikimin me reporterët, i quajti të paditur, ndërës pyetjet e tyre idiotet?**

Krasta: Politikanët aktivë që janë të lidhur me pozicionin natyrisht që janë të pakënaqur kur i bën një py-



etje të fortë, shkëputen nga realiteti e për ta thuhet se ka një raport të veçantë me Zotin dhe s'është si gjithë të tjerët. Ka pasur edhe të tjerë që kanë reaguar ndoshta dhe në forma të tjera, pra s'është i vetmi.

**- Si do reagoje për të ishe në vend të tyre?**

Ajo vajza që tha në fund, faleminderit dhe mirupafshim bëri një mbyllje të zgjuar. Kanabizimi i Shqipërisë ishte ngjarja batutat dhe grimasat e tjera janë të parëndësishme në raport me rëndësinë që ka ky fenomen

**- Është kjo mënyrë për t'ikur përgjegjësive kjo e kryeministrit?**

Për mua s'ka rëndësi, kjo është rrethana, shtypi është mënyrë komunikimi

**- A krijon kjo një lloj psikozë?**

Ka gazetarë të mirë dhe të këqij, ka të devotshëm dhe të pa devotshëm, ka që e krijojnë në kafene me miqtë, i sjellin në tv dhe bëhet ai sherri, shamataja. Ka gazetarë të mirë në këtë vend dhe të ligj, të kapur ose jo

**- Mendojnë kështu edhe qytetarët?**

Qytetarët, neve nuk duhet të na interesojë se si stigmatizohet media në këtë vend. Media ka në dorë informimin. Ne duhet të ishim alarmuar se si Erisa Zyka, një vajzë e talentuar që për fatin tonë është në Bruksel

**- Pse thoni që nuk ka shpresë?**

Në këtë vend nuk ka shpresë, ëndrra është kon-

Jo nuk e pata këtë liri, disa të ftuarit e mi kanë shkaktuar një lloj tensioni, madje një monolog i imi është hequr edhe nga youtube. Liria e fjalës është thelbi, liria e të shprehurit. Në këtë vend duhen lejuar edhe njerëz që flasin ndryshe, bëjnë pjesë të gjithë në një pazëll të tërë. Ky është një vend që ka vend për të gjithë.

ka thënë se ky vend pas llaharit të Lazaratit kaloi në një tjetër fazë, është mbjellë në çdo pëllëmbë me kanabis. Këtë media e tha. Cili është faji këtu? Media e tha dhe kanë mbështetur time, kanë respektin tim reportierët. A ka ngjarje më të madhe se mungesa e edukimit, rënia dhe shkatërrimi i shijeve, drama dhe dëshira e madhe për t'u larguar, të gjithë duan të iknin nga ky vend mizerabël. Gazetarëve në këtë vend iu duhet thënë vazhdoni përpjekjen serioze për të hapur të gjithë panoramën, problematikat e plota me devocion të madh në luftë me veten dhe me presionin. Shqipëria e momentit nuk është e bukur, por gazetaria kështu është kudo, ka gazetarë që janë vrarë për këtë profesion.

**- Pse thoni që nuk ka shpresë?**

Në këtë vend nuk ka shpresë, ëndrra është kon-

sideruar një gënjeshtër e madhe. Nëse do kisha mundësi të drejtoja këtë vend, do kisha pasur prioritetet e mia. Por lufta e shkatërron një vend, kanabisi e shkatërron vendin po kështu. Mbjellja e kanabisit bën që fëmijët tanë të pinë hashash në oborret e shkollave. Kanabisi nuk sjell rritje rrogash, pensionesh. Kryeministri dhe ministrat nga ana tjetër, kanë të drejtë në deklarata të tyre. Kjo nuk është personale. Secili nga ne ka të drejtën të luftojë për të vërtetën që njeh.

**- Çfarë mendimi keni për çështjen "Tahiri"?**

Unë nuk e kam parë këtë si çështja "Tahiri", por e kam parë si një ngjarje të madhe, një ngjarje të kanabizimit të vendit. Një vendim të madh që është marrë diku, dikur, që të mbillet kanabisi. Ajo që ne shohim është territori i këtij vendi, tashmë e konfirmuar nga të gjitha burimet

e mundshme, se është kanabizuar me qëllim, nuk mund të jetë veper e një njeriu të vetëm. Duhet të mbajnë përgjegjësinë të gjithë.

**- Mendon se Tahiri, ish-ministër i Brendshëm, është fajtor? Referuar përgjimeve të autoriteteve italiane, patentave të sekuestruara.**

Në mënyrë absolute do më vinte turp që të mbërrija unë në një konkluzion. Këto janë elementë të hetimit, dhe nuk mund të mbërrihet në konkluzione kafesh.

**- Nuk ka shumë koincidenca kjo histori?**

Gjithmonë kur insistohet, qëllimi i gazetarit është i mirëqenë. Dhe ti po insiston. Kjo është tema më e madhe, më e nxehtë, ky është një skandal i madh kombëtar. Sot po përmende shqiptarin nëpër botë të trajtojë si një person që mbjell kanabis në

ballkon. Njerëzit që kanë në dorë fatet e vendit i çojnë këto vende drejt realizimeve të mëdha, apo drejt dështimeve.

**- Marrëdhëniet e tua me kryeministrin...**

Marrëdhëniet me kryeministrin i kam siç i kam pasur tërë jetën.

**- Keni qenë mbështetës i tij...**

Unë jam shprehur pro ambasadorëve që kërkojnë rotacionin, por kam shtuar se unë jam kundër çdo qeverie, do jem edhe kundër qeverisë që do vijë. Mua më pëlqen të jem kundër strukturave arrogante. Unë mbështes gjithmonë opozitën, këtë e kam pa dilemë. Mua qeveritë nuk më pëlqejnë.

**- Nuk ju ka zhgënjyer paksa kryeministri te ajo "darka e famshme"?**

Kryeministri për Agon Channel, bëri një deklaratë të fuqishme: Aty lahen para të pista. Nëse kjo nuk del e vërtetë, gazetarët duhet ta pyesin: Cili është motivi që ai bëri një luftë për të mbyllur një stacion televiziv. Madje edhe reagimi i publikut ishte i çuditshëm, disa u gëzuan për ato dhjetëra familje që iu hoq mundësia për një rrogë.

**- Pse u largove nga "Top Channel"?**

Më kërkuan që kontrata me ta të mbyllej më herët se sa ishte përcaktuar. Nuk e kam të qartë arsyen, por në fund ishte një ndarje xhentëlmësh. Kemi koncepte të ndryshme për bërjen e televizionit. Unë jam i ndjeshëm për lirinë e fjalës, për të ftuarit, dua ata që i bëjnë drejtësi të vërtetës, që të jeta i ndershëm dhe nuk e pata këtë liri

**- Nuk e pate këtë liri?**

Jo nuk e pata këtë liri, disa të ftuarit e mi kanë shkaktuar një lloj tensioni, madje një monolog i imi është hequr edhe nga youtube. Liria e fjalës është thelbi, liria e të shprehurit. Në këtë vend duhen lejuar edhe njerëz që flasin ndryshe, bëjnë pjesë të gjithë në një pazëll të tërë. Ky është një vend që ka vend për të gjithë.

**- Si mendon për ata që thonë se tv ka të drejtë të ketë linjën e vetë editoriale?**

Po por s'mund të ketë vetëm linjën e vetë editoriale. Tan Hoxha s'e bëri "Topin" si një strukturë për të ndihmuar bizneset e tjera, ai pati një ëndërr tjetër, tv është biznes i vështirë.

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

# GAZETA SHQIPTARE

# GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

# GSH

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

## GAZETA SHQIPTARE



## Tashmë edhe lundroni!

